

EPOKA

ERE

E përditshme e pavarur
Viti XX, nr. 6078
E martë, 4 gusht 2020
çmimi 0.40 €

Nëna e UÇK-së, Aze Brahimaj, dekorohet me urdhrin "Hero i Kosovës"



FAQE 5
#NjerëzitetPaharrueshëm

Na ndiqni edhe në:

www.epokaere.com

facebook.com
Gazeta "Epoka e re"

AWR ABBRUCH GMBH
www.awr-abbruch.de

FLET PËR "EPOKËN E RE", JETA KRASNIQI | FAQE 4-5

KONSENSUSI I BRENDSHËM PËR DIALOGUN, I DOMOSDOSHËM



- Mbështetja e marrëveshjes Kosovë - Serbi nga ShBA-ja mbetet domosdoshmëri

Menaxherja e projektit në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) për dialogun Kosovë - Serbi, Jeta Krasniqi, ka vlerësuar se Kosovës i duhet një konsensus nacional për fazën finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ajo ka thënë se deri më tani skena politike është duke dëshmuar mungesë të gatishmërinë për të ndërtuar një qëndrim unik rreth procesit të dialogut. Krasniqi ka theksuar se partitë politike duken tejet të fragmentarizuara dhe nuk janë duke mundur ta dëshmojnë pjekurinë politike të nevojshme për këtë proces. Ndërsa sa i përket përfshirjes së ShBA-së në dialogun Kosovë - Serbi, ajo ka thënë se një gjë e tillë është domosdoshmëri

LIDERËT I DËSHIROJNË SHËRIM TË SHPEJTË KRYEMINISTRIT HOTI

Presidenti dhe liderët e partive politike i kanë uruar shërim të shpejtë kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, i cili është infektuar me Covid-19. Ata edhe një herë u kanë bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që të bëjnë kujdes dhe t'i zbatojnë rekomandimet

e institucioneve shëndetësore për t'u mbrojtur nga koronavirusi. Ndërsa IKShPK-ja ka njoftuar se brenda 24 orëve të fundit kanë vdekur shtatë persona si pasojë e infektimit me Covid-19 si dhe janë paraqitur 250 raste të reja të të infektuarve



MINISTRI VELIU THOTË SE SYNOJNË QË KOSOVA TA KETË POLICINË TË BESUESHME DHE PROFESIONALE

FAQE 6

RENOVA
PUTZ
Magedoni
Xhepçisht - Tetovë
Gurëz-Ferizaj
Tel: +389 44 487 300; +389 44 487 009
+389 44 487 755
Fax: +389 44 487 200
Mob: +377 44 501 289
E-mail: renova@mt.net.mk

PRINCESHA
GROUP SH.P.K.
NDËRTIM
PROJEKTIM
SHITJE
INFO: 049-111-101,
044-511-177
www.princesha-ks.com

Bunjamini
FABRIKA E LLAQEVE
MITROVICË
044/256-051
044/367-061
028/532-617
STYROKOL · BUNJAKOL · EUROFASADË

Kolegji BIZNESI
www.kolegjbiznesi.com
info@kolegjbiznesi.com
038 500 878 | 045 500 878
044 500 878 | 049 500 878

SIGMA
VIENNA INSURANCE GROUP
SIGMA INTERALBANIAN VIENNA INSURANCE GROUP SH.A
DEGA KOSOVË
Pruga "Pashko Vasa", p.n Prishtinë, Kosovë,
Tel: +381 (0)38 246 301 Fax: +381 (0)38 246 302,
E-mail: info@sigma-ks.net | www.sigma-ks.net

DINO
Konjuh Lipjan, Magj.Prishtinë Ferizaj-Kosovë
tel & fax +381 38 566 666

OPINION

SERBIA E KTHEN SHIKIMIN PRAPA TEK UÇK-ja, PASI AJO I KA SHKAKTUAR MË SHUMË DHIMBJE (22) F. 11

Shkruan:
Kudusi LAMA



AKTUALE

A E KA PEZULLUAR KOSOVA LOBIMIN? F. 6

GJERMANIA NDIHMOM SHSKUK-NË ME MJETE MBROJTËSE KUNDËR COVIDIT F. 6

PROTESTUAN INFERMIERËT, KËRKUAN QË NDËRRIMI I NATËS TË PAGUHET 36 EURO F. 6



EKONOMI

SHPALLET KONKURSI PËR DREJTOR TË DOGANËS SË KOSOVËS F. 8

JAPONIA E FOKUSUAR TA NDIHMOJË KOSOVËN NË AMBIENT DHE EKONOMI F. 8

KËRKOHET NGA BIZNESET T'I ZBATOJNË MASAT ANTI-COVID F. 8

SPORT

FC KOSOVA, 'ÇERDHE' E SHQIPTARËVE NË GJERMANI F. 16

Sot mbahet seanca konstituive e Kuvendit të Maqedonisë së Veriut

SHKUP, 3 GUSHT - Nën masa të veçanta për shkak të koronavirusit, Maqedonia e Veriut sot (e martë) do ta mbajë seancën konstituive të Kuvendit, e cila pritet të drejtohet nga ish-kryeparlamentari Talat Xhaferi. Zgjedhjet e muajit të kaluar nuk i kanë siguruar shumicën parlamentare asnjërës prej dy partive kryesore maqedonase të cilat janë duke vazhduar bisedimet me grupimet shqiptare për koalicionin. Procesi elektoral i ka siguruar shumicën socialdemokratëve në pushtet të ish-kryeministrit Zoran Zaev, 46 mandate, 2 më shumë sesa opozitarët e VMRO-DPMNE-së. Duke ditur përbërjen e dhomës legjislative me 120 vende, asnjëra prej grupimeve më të mëdha nuk ka marrë mazhorancën parlamentare. Si forca përcaktuese të aleancave politike shihen partitë shqiptare,

në krye me Bashkimin Demokratik për Integrim (BDI) të Ali Ahmetit. 15 mandatet e BDI-së së bashku me LSDM-në do të formojnë një shumicë të brishtë parlamentare dhe do ta mundësojnë vijimin e aleancës së shkuar. Mediat lokale raportojnë se kusht i shqiptarëve është posti i kryeministrit që, sipas një teorie, mund t'u jepet atyre në vitin e fundit të katërvjeçarit qeveritar. Një tjetër grupim etnik, ai i Aleancës për Shqiptarët i Ziadin Selës, ka thënë se nuk i beson Ahmetit dhe se është duke vazhduar negociatat me aktorë të tjerë politikë për t'i bashkuar 12 mandatet e veta. Lideri i VMRO-së, Hristjan Mickovski, ka thënë të dielën se ai nuk do ta mbështeste një koalicion të zgjeruar me LSDM-në si kundërpërgjigje ndaj bllokut shqiptar për çështjen e kryeministrit. Edhe për VMRO-



në një kryeministër shqiptar do të ishte në kundërshtim me parimet e saj. Bisedimet për koalicionin do të vijojnë deri më

14 gusht. Ky është afati formal kur presidenti Stevo Pendarovski duhet ta propozojë mandatarin e qeverisë dhe në fillimin e

shtatorit ky i fundit duhet ta marrë edhe miratimin në kuvend të platformës qeverisëse.

Basha: Në shtator nisim fushatën drejt fitores

TIRANË, 3 GUSHT - Pas Kryesisë, ishte edhe Këshilli Kombëtar i Partisë Demokratike (PD) që ka miratuar përbërjen e Komisionit të vlerësimit të kandidatëve të PD, pjesë e të cilit janë personalitete politike të kësaj partie dhe përfaqësues të shoqërisë civile e botës akademike. Sipas vendimit të Kryesisë dhe të Këshillit Kombëtar, Komisioni përbëhet nga: Bujar Nishani, ish-president i Shqipërisë, Besnik Mustafaj, ish-ministër i Jashtëm, Genc Ruli, ish-ministër, Enriketa Papa, pedagoge, historiane dhe studiuese e krimeve të komunizmit dhe Mark Marku, pedagog, ish-deputet. Me këtë rast, lideri i PD-së, Lulzim Basha, e ka vlerësuar lart përbërjen e këtij komisioni. "Emrat e propozuar



nga anëtarësia përbëjnë një korpus të rëndësishëm për administrimin e qeverisjes që shqiptarët do t'i besojnë PD-së dhe aleatëve të saj në zgjedhjet e

ardhshme. Përmes këtij procesi ne kemi të identifikuar jo vetëm ata që do të përzgjidhen për kandidatë për deputetë, por edhe drejtues të qeverisjes

vendore, këshillave bashkiakë dhe qeverisjes qendrore. Më të mirët e më të mirëve për të sjellë ndryshimin që presin shqiptarët, zhvillim dhe

punësim", ka thënë Basha gjatë mbledhjeve të Kryesisë dhe Këshillit Kombëtar. Ai ka thënë se anëtarësia e PD-së do ta thotë fjalën e saj përsëri në shtator, kohë kjo kur opozita do ta nis fushatën elektorale. "Muaji gusht do të jetë muaj pune intensive. Krahas përzgjedhjes së kandidatëve ne do të finalizojmë programin qeverisës të vendit, do të ngremë strukturat drejtuese të fushatës elektorale dhe organizojmë partinë për zgjedhje, duke nisur nga qendra e votimit e deri tek selia qendrore në Tiranë. Në shtator nisim fushatën elektorale, e cila do të mbyllet me fitoren e zgjedhjeve dhe hapjen e një kapitulli të qeverisjes për qytetarët dhe me qytetarët", është shprehur Basha.

Konstituohet Kuvendi i Serbisë, shqiptarët përfaqësohen me tre deputetë

BEOGRAD, 3 GUSHT - Në Serbi është bërë konstituimi i përbërjes së re të Kuvendit. Derisa po mbahej seanca, dhjetëra qytetarë kanë protestuar para ndërtesës së Kuvendit, duke brohoritur se kjo legjislaturë nuk ka legjitimitet. Me betimin e deputetëve, ka filluar afati prej 90-ditësh për

formimin e qeverisë së re. Në zgjedhjet parlamentare në Serbi lista e presidentit serb, Aleksandër Vuçiq, ka fituar më së shumti vende, 188 nga gjithsej 250. Lista e Partisë Socialiste të Serbisë - Serbia e Bashkuar ka 32 deputetë dhe Lidhja Patriotike Serbe (SPAS) 11 vende. Katër parti të pakicave kanë siguruar

ulëse në Kuvend. Lidhja e Hungarezëve e Vojvodinës ka fituar nëntë deputetë, Lista e Muamer Zukorliq do t'i ketë katër deputetë, ndërsa SDA e Sanxhakut dhe Alternativa Demokratike Shqiptare-Lugina e Bashkuar kanë nga tre vende secila. Zgjedhjet e përgjithshme janë mbajtur më 21 qershor.



Shtatë të vdekur, 250 raste të reja dhe 126 persona të shëruar nga Covid-19 në 24 orët e fundit në Kosovë

Liderët i dëshirojnë shërim të shpejtë kryeministrit Hoti

Presidenti dhe liderët e partive politike i kanë uruar shërim të shpejtë kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti, i cili është infektuar me Covid-19. Ata edhe një herë u kanë bërë thirrje qytetarëve të Kosovës që të bëjnë kujdes dhe t'i zbatojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore për t'u mbrojtur nga koronavirusi. Ndërsa IKShPK-ja ka njoftuar se brenda 24 orëve të fundit kanë vdekur shtatë persona si pasojë e infektimit me Covid si dhe janë paraqitur 250 raste të reja të të nftkuarve

**EPOKA E RE****Muhamet KOCI**

PRISHTINË, 3 GUSHT- Liderët institucionalë dhe partiakë janë solidarizuar me kryeministrin Avdullah Hoti, i cili të dielën pasdite është infektuar me Covid-19. Ata e kanë uruar kryeministrit dhe qytetarët e infektuar nga ky virus shërim të shpejtë, duke bërë thirrje për kujdes dhe për zbatim të rekomandimeve të institucioneve shëndetësore për t'u mbrojtur nga koronavirusi. "Kryeministrit Avdullah Hoti i uroj ta kalojë sa më lehtë dhe të shërohet sa më shpejtë nga Covid-19. Qytetarëve të Kosovës u bëj thirrje që t'i zbatojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore, sepse vetëm në këtë mënyrë mund ta tejkalojmë këtë periudhë të vështirë. Të gjithë të prekurve u uroj shërim dhe rikthim sa më të shpejtë në normalitet", ka shkruar Thaçi në profilin e vet në "Facebook".

Kryeministri urime për shërim sa më të shpejtë ka marrë edhe nga partnerët e koalicionit. Lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë qeveria duhet të kujdeset për ruajtjen e shëndetit të qytetarëve dhe rimëkëmbjen ekonomike. "Kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hotit dhe gjithë qytetarëve të prekur nga Covid-19, u uroj shërim të shpejtë dhe rikthim në angazhimet e tyre të përditshme. Bashkëndiej me të gjithë ata që humbën të afërmit e tyre, duke bërë thirrje te të gjithë qytetarët që në funksion të ruajtjes së jetës njerëzore, t'i respektojnë rekomandimet e institucioneve shëndetësore", ka shkruar Haradinaj në llogarinë e vet në "Facebook". Kryeministrit Hoti shërim të shpejtë i kanë dëshiruar edhe lideri i Nismës, Fatmir Limaj dhe lideri i PDK-së, Kadri Veseli. Shefi i ekzekutivit urime për tejkalimin e kësaj sëmundje, të paktën publikisht, nuk ka marrë nga

kryeparlamentarja Vjosa Osmani, e cila është nga LDK-ja dhe lideri i LV-së, Albin Kurti. Në Kosovë edhe figura të tjera politike kanë njoftuar se janë të prekur nga sëmundja Covid-19. Ndër ta është edhe kryetari i Partisë Demokratike të Kosovës, Kadri Veseli, si dhe disa deputetë të Kuvendit të Kosovës. Ndërsa kryetari i Lidhjes Demokratike të Kosovës (LDK), Isa Mustafa, ka njoftuar të shtunën se është shëruar nga Covid-19, pasi në fillim të korrikut kishte njoftuar se ishte infektuar me koronavirus.

Shtatë të vdekur dhe 250 raste të reja me Covid në Kosovë

Instituti Kombëtar i Shëndetësisë Publike i Kosovës (IKShPK) ka bërë me dije se në 24 orët e fundit kanë ndërruar jetë shtatë persona si pasojë e infektimit me Covid-19 dhe janë paraqitur 250 raste të reja. Në njoftimin për media, IKShPK-ja ka treguar se gjatë 24 orëve të fundit janë shëruar 126 persona. "Gjatë 24 orëve të fundit, në Laboratorin e Mikrobiologjisë Molekulare në IKShPK, me metodën RT-PCR janë testuar gjithsej 454 mostra

të marra nga ShSKUK-ja dhe gjurmimi i kontakteve të rasteve në terren prej të cilëve rezultojnë 250 raste pozitive. Numri total i rasteve pozitive është 9 049 raste nga 37 865 persona të dyshimtë në virusin SARS-CoV-2, me gjithsej 256 raste të vdekjes të cilët kanë pasur sëmundje të tjera shoqëruese. Gjatë 24 orëve të fundit, janë shëruar 126 pacientë derisa numri i përgjithshëm i të shëruarve

deri më sot është gjithsej 4 989 raste, kurse numri i rasteve aktive është 3 804", ka treguar IKShPK-ja.

Rastet pozitive janë nga: komuna e Prishtinës 65 raste, komuna e Mitrovicës 26 raste, komuna e Pejës 19 raste, komuna e Gjilanit 18 raste, komuna e Prizrenit 18 raste, komuna e Gjakovës 14 raste, komuna e Drenasit 10 raste, komuna e Lipjanit 10 raste, komuna e Fushës Kosovë 8

raste, komuna e Klinës 8 raste, komuna e Obiliqit 7 raste, komuna e Kaçanikut 6 raste, komuna e Vitisë 6 raste, komuna e Malishevës 5 raste, komuna e Skenderajt 5 raste, komuna e Vushtrrisë 5 raste, komuna e Kamenicës 4 raste, komuna e Suharekës 4 raste, komuna e Dragashit 3 raste, komuna e Ferizaj 3 raste, komuna e Rahovecit 2 raste dhe me nga një rast komunat e Istogut, Podujevës, Shtimes dhe Zubin Potok. Kurse ministri i Punëve të Brendshme, njëherësh koordinator i grupit ndërinstytucional për menaxhimin e incidenteve (GNMI), Agim Veliu, ka mbajtur takim me përfaqësues të këtij grupi për të diskutuar rreth situatës aktuale me pandeminë Covid-19. Pas takimit, ministri Veliu në një konferencë për media ka thënë se që e marta (sot) do të marrin vendime si grup ndërinstytucional për menaxhimin e krizave. Po ashtu, ai ka thënë se janë pajtuar që ta aktivizojnë Qendrën Operative të Ministrisë së Brendshme me sektorët e tjerë.

Kërkohet dorëheqja e Hotit

Shërim të shpejtë kryeministrit Hoti i ka dashuruar edhe deputetja nga radhët e LV-së, Mimoza Kusari-Lila, por pas shërimit ajo ka kërkuar që kryeministri të dorëhiqet. Si arsyeje për këtë ajo ka përmendur keqmenaxhimin e situatës me pandeminë. "Lajmi i mbrëmjes, z. Avdullah Hoti doli pozitiv me virusin Covid-19. Ky lajm nuk është ndonjë çudi. Tanimë virusin e kemi mes nesh dhe secili mund të jetë personi i radhës i infektuar kur nuk i respekton udhëzimet e IKShPK-së. Me

këtë rast, z. Hoti i uroj shërim të shpejtë dhe kthim në detyrën e tij nga e cila shpresoj se i shëruar dhe i fortë do të largohet së shpejti! Arsyet për këtë largim po rriten çdo ditë e më shumë", ka shkruar Kusari-Lila në profilin e saj në "Facebook".

Kjo kërkesë e deputetes ka nxitur reagimin e liderit të LDK-së, Isa Mustafa. Në profilin e tij në "Facebook", Mustafa ka shkruar se deklarimet e tilla nga deputetja janë kanibalizëm politik dhe një idiotizëm i skajshëm që

kapërcen çdo normë njerëzore. "Të ngritësh në mëngjes e ta kërcënosh Kryeministrin se do të shkarkojmë, pse të ka kapur virusi një ditë më parë, është kanibalizëm politik, një idiotizëm i skajshëm që kapërcen çdo normë njerëzore. A thua kështu i edukojmë fëmijët! Strucat e kabinetit qeveritar, këshilltarët, ministrat por edhe bashkëpartiakët e Hotit dhe të mitë heshtin, sepse atyre nuk ua ka përmendur emrin xhelatja Kusari-Lila dhe se nuk do ti hajë", ka shkruar Mustafa.

Flet për "Epokën e re", Jeta Krasniqi

Konsensusi i brendshëm për dialog

- Mbështetja e marrëveshjes Kosovë - Serbi nga ShBA-ja mbetet domosdoshmëri

Menaxherja e projektit në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) për dialogun Kosovë - Serbi, Jeta Krasniqi, ka vlerësuar se Kosovës i duhet një konsensus nacional për fazën finale të dialogut me Serbinë. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", ajo ka thënë se deri më tani skena politike është duke dëshmuar mungesë të gatishmërinë për të ndërtuar një qëndrim unik rreth procesit të dialogut. Krasniqi ka theksuar se partitë politike duken tejet të fragmentarizuar dhe nuk janë duke mundur ta dëshmojnë pjekurinë politike të nevojshme për këtë proces. Ndërsa sa i përket përfshirjes së ShBA-së në dialogun Kosovë - Serbi, ajo ka thënë se një gjë e tillë është domosdoshmëri



EPOKA E RE **Muhamet KOCI**

Prishtinë, 3 gusht - Menaxherja e projektit në Institutin Demokratik të Kosovës (KDI) për dialogun Kosovë - Serbi, Jeta Krasniqi, ka kritikuar partitë politike për mungesën e gatishmërisë për të arritur një konsensus nacional për dialogun Kosovë - Serbi. Ajo ka vlerësuar se për këtë proces Kosovës i duhet një konsensus nacional. Në këtë intervistë dhënë gazetës "Epoka e re", Krasniqi ka thënë se pesha më e madhe e ndërtimit të konsensusit politik i takon qeverisë, por edhe partitë opozitare kanë rolin e tyre. "Skena politike është duke dëshmuar mungesë të gatishmërisë për të ndërtuar një qëndrim unik rreth procesit të dialogut. Patjetër që pesha më e madhe e ndërtimit të konsensusit politik i takon qeverisë si udhëheqëse e këtij procesi, por edhe partitë opozitare kanë rolin e vet. Procesi

kërkon bashkërendim institucional, kërkon transparencë, llogaridhënie dhe gjithpërfshirje", ka thënë Krasniqi.

Ajo ka theksuar se partitë politike deri më tani po tregojnë papjekuri politike për këtë proces. "Skena politike duket tejet e fragmentarizuar dhe nuk po mund ta dëshmojë pjekurinë politike të nevojshme për këtë proces. Procesi ka rifilluar, diskutimet po mbahen, ndërsa brenda politikës së Kosovës ende nuk ka ndërmarrë hapa konkretë drejt ndërtimit të unitetit të nevojshëm për këtë proces", ka deklaruar Krasniqi.

Duke komentuar rifillimin e procesit të dialogut të Brukselit, Krasniqi ka thënë se ende nuk është e qartë agjenda e këtij procesi. "Tani pas takimeve në nivel të lartë, dhe takimeve në nivel të koordinatorëve, nuk është ende e qartë agjenda e procesit. A vazhdohet me proces aty ku ka mbetur në nivel të presidentëve apo janë duke u

ridiskutuar temat. Ndërsa tri prej temave tashmë janë bërë të qarta: personat e pagjetur, të zhvendosurit dhe zhvillimi ekonomik. Mbetet të shihet se cilat do të jenë temat e radhës dhe si do të arrihet të ndërtohet procesi deri te gatishmëria e palëve për ta përmbyllur atë me njohje formale reciproke", është shprehur ajo.

"Epoka e re": Znj. Krasniqi, tashmë ka rifilluar procesi i dialogut ndërmjet Kosovës dhe Serbisë. Si e keni parë takimin e parë të nivelit politik dhe më pas takimet e koordinatorëve?

Krasniqi: Me heqjen e të gjitha masave, në radhë të parë tarifën prej 100 përqindësh dhe më pas dhe masat e reciprocitetit ndaj produkteve të importuara nga Serbia, rifillimi i procesit të dialogut ishte i pritshëm. Ndërsa u prit që do të kishte një Samit në Uashington dhe potencialisht një marrëveshje qoftë me bazë ekonomike që do të shtyhej përpara nga kryeqyteti amerikan,

zhvillimet e tjera politike ndikuan në mosmbajtjen e këtij takimi. Në anën tjetër, ashtu siç ishte paralajmëruar, pas takimeve të emisarit special të BE-së, Miroslav Lajçak, palët do të rifillonin takimet ku Samiti i Parisit, i organizuar nga presidenti Macron me pjesëmarrje të kancelares Merkel, për t'ia dhënë mbështetjen politike të nevojshme këtij procesi dhe për ta shprehur interesimin e BE-së rreth tij. Ashtu siç u deklarua më pas, ky samiti synoi t'i ofronte mbështetje rifillimit të procesit të dialogut si dhe vetë emisarit special Lajçak për ta përçuar mesazhin që BE-ja qëndron prapa Lajçakut në këtë proces. Ajo çfarë mbetet për ne e rëndësishme si Kosovë është ta qartësojmë pozicionin tonë në këtë proces, përfshirë dhe pritshmëritë tona nga procesi. Kosova duhet t'i qartësojë kërkesat e veta ndaj BE-së, shteteve anëtare si dhe ShBA-së. Duhet të kërkohej që procesi

të mos ketë më ambiguitet në artikullimin e marrëveshjes, ndërsa të ketë një përfshirje më të madhe të vet Gjermanisë dhe Francës si dhe ShBA-së për ta shtyrë atë drejt rezultatit të pritshëm - njohjes reciproke. Vërtet Lajçaku përfaqëson BE-në, por vendimmarrja e BE-së është brenda shteteve anëtare, pra Këshillit. Andaj edhe kjo çështje kërkon vëmendjen e shtuar të shteteve anëtare pasi në kuadër të tij kërkohej njohja nga 5 shtetet jonjohëse, ofrimi i perspektivës së qartë dhe të prekshme për Kosovë, të cilat Lajçaku i vetëm nuk mund t'i ofrojë apo garantojë.

"Epoka e re": Opozita, por edhe vetë partnerët e koalicionit qeverisës e kanë kritikuar qasjen e kryeministrit Hoti në këtë proces, duke thënë se Kosova po rrezikon të rrëshqasë në dialog teknik me Serbinë. Sa janë reale këto shqetësime?

Krasniqi: Duhet të kuptojmë drejt se çfarë nënkuptohet me

Kurti takon të mbijetuarën e vetme të familjes Elshani nga Korrotica e Ulët e Drenasit

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Kryetari i Lëvizjes Vetëvendosje, Albin Kurti, ka takuar Teuta Elshanin, të mbijetuarën e vetme të familjes Elshani nga Korrotica e Ulët e Drenasit. Kurti ka thënë se Teuta Elshani ka shpëtuar atë ditë sepse ishte studente e kimisë në Prishtinë. "Më 17 prill 1999 forcat serbe në masakrën e Poklekut të Vjetër vrasin shkrimtarin Ymer Elshani,

bashkëshorten e tij Nafijen, katër djemtë Ardianin (25 vjeç), Miranin (20), Kujtimin (15) e Nderimin (10), si dhe kumatën e tij Shukrijen. Të nesërmen ia vrasin edhe nënën Nailen, motrën e heroit Fazli Greiçevci. Teuta Elshani ka shpëtuar atë ditë sepse ishte studente e kimisë në Prishtinë. E mbijetuarë e vetme e familjes nga Korrotica e Ulët e Drenasit, që

prej 20 vjetësh jeton në Atlanta të ShBA-së. Ajo ka katër fëmijë: Ejonën, Erën, Miranën dhe Ardianin. Për çdo vit vjen në Kosovë nga dashuria për vendlindjen e me ngushëllimin e vetëm që gjyshja Naile në çastet e fundit të jetës së saj nuk kishte qenë në dijeni se një ditë më parë ia kanë vrarë djalin e katër nipat", ka shkruar Kurti në llogarinë e vet në "Facebook".



un, i domosdoshëm



dialog teknik dhe atë politik. Në radhë të parë, duhet thënë se çështjet të cilat janë diskutuar në mes të Kosovës dhe Serbisë që nga viti 2011 janë politike, edhe pse natyra e tyre mund të duket teknike. Përgjatë negociatave palët kanë ruajtur qëndrimet e tyre rreth statusit të Kosovës, Kosova si shtet i pavarur përballë Serbisë e cila nuk e ka pranuar të njëjtën, prandaj dhe vetë marrëveshjet janë mveshur me natyrë të paqartësisë, që u njoh si ambiguiteti konstruktiv, ku secila palë kishte hapësirën e nevojshme për t'i interpretuar marrëveshjet sipas qëndrimeve të tyre politike.

Faza finale e dialogut ka filluar në qershor 2017 në nivel të dy presidentëve, ku u tha se do të arrihej një marrëveshje gjithëpërfshirëse ligjërishit e obligueshme. Deri në pezullim të dialogut palët kanë zhvilluar diskutime rreth një sërë çështjesh të cilat janë bërë të njohura për publikun në një dokument që presidenti pat ndarë në janar 2019 me delegacionin shtetëror. Ndër çështjet e u bënë të ditura: të pagjeturit, të zhvendosurit, trashëgimia kulturore, prona, të drejtat e minoriteteve /komuniteteve joshumicë, kthimi i artefakteve arkeologjike dhe etnologjike në Kosovë, bashkëpunimi ekonomik /infrastrukturor; marrëveshjet që janë arritur në kuadër të dialogut të lehtësuar nga Bashkimi Evropian. Ndërsa dihet që çështja e korrigjimit të kufijve ishte pjesë e diskutimit mbi të cilën nuk pat mbështetje të brendshme në Kosovë por, mbi të gjitha, kishte një

qëndrim të ndarë të faktorit ndërkombëtar, përkatësisht Gjermanisë dhe ShBA-së.

Në këtë fazë palët pritet të flasin për një marrëveshje të vetme, pra të arrijnë dakordim për një sërë çështjesh në paketë, dhe jo më si në të kaluarën, të arrihen marrëveshje individuale për çështje të caktuara, për shembull, diplomat, lëvizja e lirë e kështu me radhë. Kjo çështje duhet sqaruar pasi tema e parë kishte të bënte me të pagjeturit. Kjo është një temë shumë e ndjeshme dhe duhet kuptuar që nëse nuk ka pajtim për të gjitha çështjet nuk do të ketë për asnjërin. Pra, duhet të bëhet menaxhimi i pritshmërisë me anë të ofrimit të informacionit të duhur dhe qartësimin e vet procesit.

Tani pas takimeve në nivel të lartë, dhe takimeve në nivel të koordinatorëve, nuk është ende e qartë agjenda e procesit. A vazhdohet me proces aty ku ka mbetur në nivel të presidentëve apo janë duke u ridiskutuar temat. Ndërsa tri prej temave tashmë janë bërë të qarta: personat e pagjetur, të zhvendosurit dhe zhvillimi ekonomik. Mbetet të shihet se cilat do të jenë temat e radhës dhe si do të arrihet të ndërtohet procesi deri te gatishmëria e palëve për ta përmblyllur atë me njohje formale reciproke.

“Epoka e re”: Qeveria aktuale po shihet se është e brishtë nga numrat. A besoni se është e përgatitur dhe e gatshme që kjo qeveri të përballet me këtë proces?

Krasniqi: Procesi i dialogut Kosovë - Serbi është një proces që shkon përtej një qeverie, siç e kemi parë tashmë, pasi procesi ka filluar që më 2011. Edhe nëse arrihet një marrëveshje në mes palëve, gjatë këtij viti apo vitin e ardhshëm, e njëjta duhet të zbatohet dhe zbatimi do të marrë kohë, duke kaluar nga një qeveri te tjetra. Prandaj duhet të ndërtohet një konsensus i brendshëm politik i cili shkon përtej agjendave politike ditore, por që konsiston në agjendë shtetërore të mirë menduar dhe të projektuar për periudhë afatgjatë.

“Epoka e re”: Edhe në debatin e fundit parlamentar u pa se subjektet politike nuk mund ta unifikojnë një qëndrim për këtë çështje. Cila duhet të jetë qasja e institucioneve të Kosovës karshi dialogut të Brukselit, në mënyrë që të mos përsëriten gabimet e kaluara në këtë proces?

Krasniqi: Skena politike është duke dëshmuar mungesë të gatishmërisë për të ndërtohet një qëndrim unik rreth procesit të dialogut. Patjetër që pesha më e madhe e ndërtimit të

konsensusit politik i takon qeverisë si udhëheqëse e këtij procesi, por edhe partitë opozitare kanë rolin e tyre. Procesi kërkon bashkërendim institucional, kërkon transparencë, llogaridhënie dhe gjithëpërfshirje. Skena politike duket tejet e fragmentarizuar dhe nuk po mund ta dëshmojë pjekurinë politike të nevojshme për këtë proces. Procesi ka rifilluar, diskutimet po mbahen, ndërsa brenda politikës së Kosovës ende nuk ka ndërmarrë hapa konkretë drejt ndërtimit të unitetit të nevojshëm për këtë proces.

“Epoka e re”: Kjo qeveri vazhdimisht ka thënë se do të ketë transparencë të plotë në këtë proces. Sa ka pasur transparencë për takimet e zhvilluara deri me tani?

Krasniqi: Transparenca nuk ka qenë elementi më i fortë i këtij procesi që në fillim. Duket se mungesa e transparencës është duke e karakterizuar edhe këtë fazë të tij, pavarësisht prej deklaratave të qeverisë se do të jetë transparente rreth dialogut. Është më se e kuptueshme që në proces të negociatave, siç janë dhe këto Kosovë - Serbi, ekziston një masë e konfidencialitetit, por nevoja për transparencë ka të bëjë me qartësimin e procesit, pritshmërinë e palës së Kosovës dhe qasjen që do ta mbajë. Lajçaku në vizitën e tij në Kosovë deklaroi se ka një pajtim rreth elementeve të procesit, të cilat ende nuk janë bërë publike. Transparenca është e nevojshme për ta fituar edhe mbështetjen dhe besimin e shoqërisë ndaj këtij procesi.

“Epoka e re”: Në këtë fazën fillestare nuk kemi parë ndonjë pjesëmarrje shumë aktive të ShBA-së në dialogun e Brukselit. Cili mendoni se do të jetë roli i ShBA-së në vazhdim të këtij procesi?

Krasniqi: ShBA-ja ka luajtur një rol të rëndësishëm që nga fillimi i këtij procesi në vitin 2011. Mbështetja e saj ka qenë qenësore për t'i shtyrë palët drejt arritjes së marrëveshjeve në ndërmjetësimin e BE-së, përfshirë këtu edhe marrëveshjen e prillit të 2013-s. Duke konsideruar që tashmë po proklamohet që palët synojnë të arrijnë një marrëveshje gjithëpërfshirëse ligjërishit të obligueshme në kuadër të së cilës synohet njohja reciproke, mbështetja e ShBA-së mbetet domosdoshmëri. Duhet kuptuar që nëpërmjet këtij procesi Kosova duhet ta synojë konsolidimin e subjektivitetit të vet ndërkombëtar që do të vijë me anëtarësimin në OKB. Prandaj, ShBA-ja duhet të jetë pjesë e procesit për të arritur deri te përmbushja e këtyre pritshmërive nga procesi.

Nëna e UÇK-së, Aze Brahimaj, dekorohet me urdhrin ‘Hero i Kosovës’

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Janë bërë 22 vjet që nga koha kur forcat serbe kanë vrarë Aze Brahimaj, e cila është cilësuar si nëna e Ushtrisë Çlirimtare të Kosovës (UÇK), pasi në kohët më të vështira ajo është kujdesur për shumë ushtarë të UÇK-së. Në këtë përvjetor ajo është përkujtuar nga ish-drejtuessit kryesorë të UÇK-së, Hashim Thaçi, Kadri Veseli dhe Ramush Haradinaj.

Për kontributin për lirinë e vendit, presidenti i Kosovës, Hashim Thaçi, ka dekoruar nënën Aze me titullin “Hero i Kosovës”. Me këtë rast, ai ka kujtuar edhe kohën kur ka qëndruar në shtëpinë e saj në kohët më të vështira. “Nënëlojka Aze njëzet e katër orë gatuante për luftëtarët e lirisë. Ata shkonin të rraskapitur, çlodheshin, ushqeheshin dhe më pas vazhdonin rrugën drejt fronteve të luftës. Gjithmonë në duar të sigurta. E kujtoi rastin kur së bashku me Kadriun, Luanin dhe Shkëlzenin qëndruam në një acar dimri aty. Po ashtu, në familjen Ibrahimaj qëndruan shumë herë edhe Fehmiu e Xheva. Forcat serbe nuk u mjaftuan me shuarjen e jetës së nënëlokes Aze. Ata e masakruan pas vrasjes, në shenjë hakmarrjeje ndaj kësaj familjeje, e cila gjithmonë ishte derëhapur dhe e angazhuar me të gjithë anëtarët e familjes në lëvizjen kombëtare. Me rastin e 22-vjetorit të vrasjes, nënëloken Aze e dekorova me urdhrin ‘Heroinë e Kosovës’, për kontributin e madh për lirinë dhe pavarësinë e Kosovës. Lavdi emrit dhe veprës së heroinës Aze Brahimaj!”, ka shkruar Thaçi në llogarinë e vet në

“Facebook”.

Ndërsa kryetari i PDK-së, Kadri Veseli, ka thënë Aze ishte një trimëshë e pashembullt, e cila ka luftuar bashkë me djemtë dhe vajzat e Kosovës. “Nuk do ta harroj kurrë përkujdesjen e saj të madhe sikur për djalin e vet, bukën nga duart e saj, fjalët dhe mirësinë e saj, gjatë shumë netëve që kam kaluar në shtëpinë e tyre në Shqiponjë (ish-Jabllanicë), gjatë viteve të hershme të luftës sonë. Nga urtësia dhe shpirti luftarak i nënës Azë Brahimaj kemi marrë dashuri dhe forcë në rrugëtimin tonë të lirisë. Kujtimi për të do të jetë i përjetshëm. Lavdi!”, ka shkruar Veseli në llogarinë e vet në “Facebook”.

Në anën tjetër, lideri i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se nëna Aze ka qenë shtyllë e fuqishme e UÇK-së që në fillimet e organizimit të luftës për liri. Ai ka thënë se trimëria, guximi dhe sakrificat e saj e bënë të veçantë e të paharruar në kujtimin e shqiptarëve. Nëna Aze është përkujtuar edhe nga djali i saj Lahi Brahimaj. Ai ka thënë se ajo do të mbetet nëna e UÇK-së. “Nëna Aze, përkujtimet për nënën janë të vështira gjithmonë, por për mua aq sa qenka e rëndë, qenka edhe krenari. Kur ne vendosim t'i dilnim përballë armikut, ti na dhe bekimin dhe u bërë krahu ynë në këtë rrugë, u bërë shoqe e bashkëluftëtare për ne, u bërë nëna e UÇK-së siç të quanin shokët bashkëluftëtarë kur u rrije gati e kujdeseshe po me atë dashuri të nënës si për ne djemtë e tu”, ka shkruar Brahimaj në llogarinë e vet në “Facebook”.



#NjerëztëPaharrueshëm



Ministri Veliu thotë se synojnë që Kosova ta ketë policinë të besueshme dhe profesionale

Prishtinë, 3 gusht (ER) - Ministri i Punëve të Brendshme (MPB), Agim Veliu, pas një vizite që ka pasur në Inspektoratin Policor të Kosovës (IPK), ka thënë se i ka ofruar mbështetje këtij institucioni në mënyrë që qytetarët e vendit dhe partnerët ndërkombëtarë të kenë një polici profesionale dhe të besueshme. "Pata kënaqësinë që sot ta vizitojë Inspektoratin Policor të Kosovës, ku u njoftova edhe me punën dhe me menaxhmentin, si dhe me një pjesë të stafit. Po ashtu i vizitova edhe hapësirat e punës së inspektoratit. Unë i premtova mbështetje ushtruesit të detyrës së



kryeshefit sepse qëllimi ynë i përbashkët është që ta kemi gjithsesi një polici profesionale, të besueshme edhe për qytetarinë Republikës së

Kosovës, por edhe për partnerët tanë ndërkombëtarë", ka thënë Veliu, duke shtuar se do ta përkrah IPK-në në të gjitha fushat. "Po ashtu, unë do ta

mbështes inspektoratin edhe për çështje të tjera që janë profesionale, me anë të trajnimeve. Po ashtu, kontributi i ministrisë do të jetë në ofrimin

e inspektoratit me vendet e tjera për sa iu takon edhe marrëveshjeve ndërkombëtare që duhet t'i ketë me inspektoratet dhe policinë me vendet e tjera në mënyrë që luftimi i çfarëdo forme të krimit të jetë sa më efikas", ka thënë Veliu. Ndërsa ushtruesi i detyrës i kryeshefit të Inspektoratit Policor të Kosovës (IPK), Kushtrim Hodaj, ka thënë se e kanë njoftuar ministrin Veliu për funksionimin e këtij institucioni, me aktivitetet si dhe sfidat dhe problemet që i ka IPK-ja. Hodaj ka shprehur gatishmërinë për ndërmarrjen e veprimeve në funksion të mbrojtës së përhapjes së Covid-19.

Gjermania ndihmon ShSKUK-në me mjete mbrojtëse kundër Covidit



PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Ministri i Shëndetësisë (MSh), Armend Zemaj dhe ambasadori i ri i Gjermanisë në Kosovë, Jorn Rohde, kanë marrë pjesë të hënën në ceremoninë e dorëzimit në Institutin Kombëtar të Shëndetësisë Publike të Kosovës (IKShPK) të një kontingjenti të pajisjeve mbrojtëse personale dedikuar Shërbimit Spitalor, Klinik dhe Universitar të Kosovës (ShSKUK) dhe institucioneve shëndetësore si përgjigje kundër Covid-19. Kontingjenti që përmban 17 mijë maska, respiratorë FFP2 (EN149) /N95 (NIOSH), 5 500 pako me dorëza nitrile të madhësive të ndryshme dhe 3 700 litrave me dezinfektues,

është financuar nga autoritetet e shtetit të Gjermanisë. Me këtë rast, ministri Zemaj ka vlerësuar lart kontributin e shtetit të Gjermanisë dhe të Bashkimit Evropian (BE) në asistencën dhënë Kosovës për luftimin e Covid-19. Ai ka thënë se MSh-ja dhe profesionistët shëndetësorë të Kosovës janë mirënjohës për këtë përkrahje të cilën do ta manifestojnë me angazhim konkret kundër Covid-19. Ndërsa ambasadori Rohde ka thënë se ky është një kontribut nga shteti gjerman për popullin e Kosovës dhe profesionistët shëndetësorë. Në këtë kontekst, ai ka këshilluar qytetarët që t'u përmbahen udhëzimeve dhe t'i zbatojnë masat e qeverisë për t'u mbrojtur nga Covid-19.

Protestuan infermierët, kërkuan që ndërrimi i natës të paguhet 36 euro

PRISHTINË, 3 GUSHT - Duke respektuar distancën dhe duke mbajtur maskën si dy masa preventive për parandalimin e Covid-19, infermierët dhe mamitë e Kosovës në këtë kohë pandemie kanë protestuar para Qeverisë së Kosovës. Ata kanë kërkuar që ndërrimi i natës, i cili paguhet 18 euro, të paguhet 36 euro. Fitim Havolli nga Sindikata e Infermierëve dhe Mamive të Kosovës ka thënë se përmes kësaj proteste kanë kërkuar që qeveria ta kthejë kokën kah ky komunitet i cili është në front të parë me pacientët e prekur me Covid-19. Ai ka thënë se kërkesa e tyre është që ndërrimi i natës të paguhet 36 euro, pasi aktualisht pagesa për

ndërrim të natës është 18 euro. Havolli është shprehur se nuk janë duke kërkuar rritje pagash, por që kërkesat e tyre nga qeveria të trajtohen me prioritet. Pas kësaj proteste, një delegacion i infermierëve janë takuar me kryetaren e Kuvendit, Vjosa Osmani, e cila u ka dhënë mbështetje kërkesave të tyre. "Puna juaj për ofrimin e shërbimeve mjekësore për pacientët e prekur me virusin Covid-19 është tepër e rëndësishme. Por, krahas këtij trajtimi, komunikimi social dhe aspekti psikologjik, të cilin ju po ua ofroni pacientëve të prekur nga ky virus, është po kështu shumë i rëndësishëm", ka thënë Osmani.



A e ka pezulluar Kosova lobimin?



Zyrtarë të Qeverisë së Kosovës kanë deklaruar se institucionet shtetërore dhe miqtë ndërkombëtarë janë duke punuar që shteti ynë të bëhet anëtar i shumë organizatave ndërkombëtare, përfshirë edhe ato financiare. Ndërsa njohësit e zhvillimeve politike kanë vlerësuar se Kosova deri më tash ka dështuar të ndërtojë një diplomaci funksionale dhe profesionale. Ata kanë thënë se Kosova ka ngecur sa i takon çështjes së lobimit për njohje të reja, por edhe për anëtarësim në organizata ndërkombëtare

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Përfaqësues të Qeverisë së Kosovës kanë thënë se institucionet, bashkë me mekanizmat e tjerë ndërkombëtarë, janë duke punuar që Kosova të bëhet anëtare e shumë organizatave ndërkombëtare, përfshirë edhe ato financiare. Ndërkaq njohësit e zhvillimeve politike theksojnë se Kosova deri më tash ka dështuar të ndërtojë një diplomaci funksionale dhe profesionale. Kosova, sipas tyre, ka ngecur sa i takon çështjes së lobimit për njohje të reja, por edhe për anëtarësim në organizata ndërkombëtare. Në Ministrinë e Punëve të Jashtme dhe të Diasporës kanë thënë se ky institucion po "vazhdon të punojë për forcimin e subjektivitetit ndërkombëtar të Republikës së Kosovës". Në një përgjigje për "Radion Evropa e Lirë", nga zyra për informim e kësaj ministrie thuhet se Kosova deri tash është anëtare e 106 mekanizmave shumëpalësh (ndërkombëtarë dhe rajonalë) dhe 34 organizatave sportive. Por, zyrtarë të kësaj ministrie nuk kanë dhënë përgjigje konkrete në pyetjen se në cilat organizata ndërkombëtare po synon të aplikojë Republika e Kosovës dhe a është duke lobuar për njohje të reja të pavarësisë. Në muajin qershor të këtij viti, i dërguari i posaçëm i presidentit amerikan për dialog mes Kosovës dhe Serbisë,

Richard Grenell, ka thënë se "Kosova është pajtuar që t'i pezullojë përpjekjet për t'u anëtarësuar në organizatat ndërkombëtare, ndërsa Serbia u pajtua që ta pezullojë përkohësisht fushatën e çnjohjeve të pavarësisë së Kosovës". Kjo u bë për t'i dhënë mundësi vazhdimin të dialogut për normalizimin e marrëdhënieve. Dialogu ishte ndërprerë në fund të vitit 2018, kur Qeveria e Kosovës vendosi taksën 100 për qind ndaj produkteve nga Serbia dhe Bosnjë e Hercegovina. Grenell, gjithashtu, pati paralajmëruar se të dyja palët do të takoheshin në Shtëpinë e Bardhë më 27 qershor. Por, ky takim është anuluar për shkak të njoftimit për një aktakuzë kundër presidentit të Kosovës, Hashim Thaçit nga Prokuroria e Specializuar në Hagë. Dialogu, megjithatë, ka vazhduar në Bruksel më 16 korrik, mes kryeministrit të Kosovës, Avdullah Hoti dhe presidentit serb Aleksandër Vuçiq. Ndërkohë, kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka deklaruar në Kuvendin e Kosovës se "nuk ka pezullim të aktiviteteve për lobim". Njohës të çështjeve politike dyshojnë se për këtë çështje ka pasur marrëveshje zyrtare në mes të dy palëve. Profesori Gëzim Visoka, ligjërues për studimet mbi paqen dhe konfliktet në Dublin City University në Irlandë, ka thënë se Serbia ka argumentuar

se do t'i japë fund fushatës së çnjohjes kur Kosova ose aleatët e saj ta përfundojnë fushatën e tyre të njohjes. Visoka mendon se si pjesë e rifillimit të dialogut të ndërmjetësuar nga BE-ja, Serbia dhe Kosova janë pajtuar që t'i ndërpresin veprimet që mund të duken të dëmshme karshi normalizimit të raporteve ndërshtetërore por, sipas tij, duket se ka qenë më shumë premtim gojor sesa marrëveshje e shkruar. "Për Serbinë, çnjohja Kosovës është një përpjekje për ta çakorduar dhe përfundimisht për t'u dhënë fund përpjekjeve të Kosovës dhe aleatëve të saj për njohje ndërkombëtare dhe anëtarësim në organizata ndërkombëtare", ka thënë Visoka, duke shtuar se kjo është një përpjekje diplomatike e Serbisë që synon të krijojë një status quo të re, ku Beogradi zyrtar mban epërsi në bisedimet e ardhshme me Kosovën. Edhe Afrim Hoti, profesor i të Drejtës Ndërkombëtare në Universitetin e Prishtinës, ka thënë se nëse do të ekzistonte një marrëveshje e tillë, do të duhej të respektohej nga të dyja palët. "Në të kundërtën, nëse nuk ekziston një marrëveshje e tillë, atëherë është paradoksale të hiqet dorë nga aplikimi nëpër organizata ndërkombëtare dhe jo vetëm në UNESCO dhe INTEPOL, por të vazhdohet me një numër relativisht ku Kosova e ka derën e hapur, qoftë ato agjenci të

specializuara të Kombeve të Bashkuara, ku nuk është e domosdoshme të jesh anëtar i OKB-së", ka thënë Hoti. Këto vitet e fundit, thotë Hoti, Kosova ka humbur kohë jashtëzakonisht shumë për shkak të agjendës së brendshme politike, duke u marrë me çështje sekondare dhe terciare, kurse vendi, sipas tij, është lënë pa u anëtarësuar në organizata ndërkombëtare. Kurse sa i përket deklarimit të kryeministrit Hoti, se "nuk ka pezullim të aktiviteteve për lobim", profesori Gëzim Visoka ka thënë se nëse "deklarata përcillet me një strategji dhe veprime serioze diplomatike, duhet mirëpritur dhe shikuar si përpjekje për ringjalljet të politikës së jashtme të Kosovës". Mirëpo, nëse është kjo deklarata është bërë si retorikë për përdorim vendor apo për ta shtyrë dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja, sipas Visokës, do të ketë pasoja negative për Kosovën. "Kjo për faktin se Serbia që tani ka paralajmëruar vazhdimin e fushatës për çnjohje dhe fajin për ngecjen të dialogut, BE-ja do t'ia lë Kosovës. Pra, Kosova duhet ta ndajë politikën e saj për njohje me dialogun e ndërmjetësuar nga BE-ja. Këto mund ta bëjë vetëm nëse zhvillon një fushatë të re strategjike dhe afatgjatë për fuqizim të subjektivitetit të saj ndërkombëtar", ka thënë Visoka. Kryeministri Hoti gjatë javës së

kaluar ka thënë se anëtarësimi i Kosovës në organizata të ndryshme ndërkombëtare bëhet në koordinim me partnerët ndërkombëtarë dhe se, sipas tij, pa mbështetjen ndërkombëtare, Kosova nuk mund të anëtarësohet në asnjë organizatë. "Çdo anëtarësim i Kosovës në organizata ndërkombëtare bëhet gjithmonë në koordinim me partnerët tanë ndërkombëtarë. Kjo është e vërteta. Ne jemi pajtuar që në këtë proces të rrugëtojmë bashkë sepse e dimë se po nuk e patëm këtë mbështetje. Nuk mund të çojmë përpara këtë agjendë të anëtarësimit në organizata ndërkombëtare", është shprehur Hoti pas një vizite në Ministrinë e Mbrojtjes. Pengesat më të mëdha Kosova i ka pasur dhe vazhdon t'i ketë nga shteti i Serbisë, i cili nuk e njeh pavarësinë e Kosovës. Serbia që nga viti 2017 ka bërë fushatë agresive diplomatike për tërheqjen e njohjeve të shtetit të Kosovës. Zyrtarët e Ministrisë së Jashtme të Serbisë kanë deklaruar se më shumë se dhjetë vende e kanë tërhequr njohjen e Kosovës. Për shkak të lobimit kundër pavarësisë së Kosovës nga ana e Serbisë, disa shtete thuhet se kanë ngrirë raportet e bashkëpunimit me Kosovën. Fushata e Serbisë ka penguar që Kosova të anëtarësohet në: Organizatën Ndërkombëtare të Policisë Kriminale (INTERPOL) dhe Agjencinë për Arsime, Shkencë dhe Kulturë të Kombeve të Bashkuara (UNESCO). Përveç INTERPOL-it dhe UNESCO-s, Kosova nuk është anëtare as e Organizatës së Kombeve të Bashkuara, Bashkimit Evropian, Këshillit të Evropës, Organizatës Botërore të Tregtisë, Organizatës Botërore të Shëndetësisë dhe Organizatës për Siguri dhe Bashkëpunim në Evropë. Organizatat në të cilat është anëtarësuar Kosova janë: Banka Botërore, Fondi Monetar Ndërkombëtar, Banka Evropiane për Rindërtim e Zhvillim, Federata Botërore e Futbollit, Federata Evropiane e Futbollit, Komiteti Olimpik, Organizata Botërore e Doganave, Marrëveshja për Tregti të Lirë e Evropës Qendrore (CEFTA). Po ashtu, Kosova dhe Agjencia e Bashkimit Evropian për sundim të ligjit, EUROPOL, më 27 korrik kanë nënshkruar një marrëveshje bashkëpunimi, me qëllim që të luftohen krimet e rënda. Sipas ministrit të Punëve të Brendshme, Agim Veliu, që nënshkroi këtë marrëveshje, ajo do t'i avancojë dhe forcojë kapacitetet e Kosovës në luftimin e kriminalitetit. Kosova, në bazë të kësaj marrëveshjeje, do të ketë oficerë ndërlidhës në EUROPOL.

Japonia e fokusuar ta ndihmojë Kosovën në ambient dhe ekonomi

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Ministri i Ekonomisë dhe Ambientit, Blerim Kuçi, ka pritur në takim një delegacion të Ambasadës së Japonisë në Kosovë, i përbërë nga i ngarkuari me punë në këtë ambasadë, Mitsunori Ogasawara. Fillimisht Kuçi e ka falënderuar Ogasawaran për ndihmën që nga paslufta shteti japonez ka dhënë për Kosovën. Më tutje, ai e ka njoftuar atë me gjendjen aktuale ekonomike në vend dhe me nismat qeveritare për ta rimëkëmbur ekonominë, ku ka kërkuar që strategjitë dhe planet e agjencive të huaja dhe ambasadave do të duhet të përshtaten me pakon e

rimëkëmbjes ekonomike në Kosovë. "Ne jemi në një kohë pandemie dhe gjendja ekonomike nuk është e mirë si në shumë vende të botës. Ajo që ka rëndësi, është plani për rimëkëmbje ekonomike, që ka filluar mirë me miratimin e rishikimit të buxhetit, por që pret edhe kalimin e dy ligjeve që të na hapë rrugën për veprim më të shpejtë, ku ndihma do të shkojë te qytetarët, ndërmarrjet private dhe ndërmarrjet publike", ka thënë Kuçi.

Ndërsa Ogasawara është shprehur i gëzuar për vazhdimin e projektit që ka të bëjë me ndotjen e ajrit e që ndihmohet nga JICA japoneze.



Ai ka thënë se janë të fokusuar në ambient dhe ekonomi, duke përmendur sektorin e menaxhimit të mbeturinave dhe disa

ndihma që janë dhënë në regjionin e Prizrenit. Ministri Blerim Kuçi dhe i ngarkuari me punë në këtë ambasadë,

Mitsunori Ogasawara, janë pajtuar që bashkëpunimi në mes të dy vendeve të jetë konkret dhe afatgjatë.

Hoti: Sapo të hyjë në fuqi ligji për buxhetin do t'i nisim pagesat e mbetura përgjysmë

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Kryeministri i Kosovës, Avdullah Hoti, ka thënë se qeveria që ai udhëheqë mbetet e përkushtuar në dy prioritete: luftën kundër koronavirusit dhe rimëkëmbjen ekonomike. Sa i përket rimëkëmbjes ekonomike, Hoti ka thënë se sapo të hyjë në fuqi Ligji për rishikimin e buxhetit do të ndahen mjetet financiare për qytetarët dhe bizneset që janë paraparë në Pakon Emergjente Fiskale, që ishte miratuar nga qeveria e kaluar, e udhëhequr nga Albin Kurti. "Ministrat e resorëve ekonomikë kanë



marrë detyrat për t'i bërë përgatitjet për zbatim të masave për ndihmë qytetarëve dhe bizneseve. Sapo të hyjë në fuqi

Ligji për buxhetin do t'i nisim pagesat e mbetura përgjysmë. Presim që Kuvendi të miratojë këtë javë edhe Ligjin për

rimëkëmbje ekonomike për të hapur rrugë për zbatim të të gjithë pakos për rimëkëmbje ekonomike", ka shkruar Hoti, duke shtuar se Kosova është duke u parë si faktor stabiliteti në rajon. "Krahas këtyre, Kosova po shihet si faktor stabiliteti në rajon dhe më gjerë për shkak të qasjes konstruktive, të matur dhe të koordinuar me miqtë tanë sa i përket dialogut, marrëdhënieve regjionale dhe marrëdhënieve ndërkombëtare", ka shkruar ai.

Duke folur për pandeminë Covid-19, Hoti ka thënë

ministri i Shëndetësisë, Armend Zemaj dhe drejtori i ShSKUK-së, Valbon Krasniqi, janë duke u angazhuar me të gjitha kapacitetet për krijimin e shtretërve shtesë për rastet që mund të paraqiten. "Po punojmë edhe me donatorë dhe vende mike për të krijuar këto kapacitete sa më parë, përfshirë edhe kapacitetet testuese shtesë. Së shpejti licencohen edhe spitalet-laboratorët privatë për të kryer testimet. Mbikëqyrja e zbatimit të masave do të vazhdojë pa pardon", ka shkruar kryeministri Hoti.

Pronarët e pishinave kundërshtojnë vendimin e qeverisë

PRISHTINË, 3 GUSHT - Vendimet e fundit të Qeverisë së Kosovës kundër pandemisë Covid-19 kanë ngjallur pakënaqësi te disa kategori ekonomike. E lidhur me këtë disa dhjetëra përfaqësues të pishinave kanë protestuar para Qeverisë së Kosovës. Ata kanë vendosur që në këtë mënyrë ta kundërshtojnë vendimin e qeverisë që ua

ndalon punën pishinave të hapura.

Diamant Paçarizi, përfaqësues i tyre, ka thënë se vendimi i qeverisë për mbylljen e pishinave ka lënë pa punë shumë persona edhe përkundër sa janë të detyruar që t'i mirëmbajnë ambientet e punës. Ai, po ashtu, ka paralajmëruar edhe bllokim të kufirit me Shqipërinë nëse qeveria sonte

nuk e ndryshon vendimin. "Nëse qeveria s'merr vendim deri sonte, në njoftojmë se protestën e radhës do ta mbajmë në kufirin me Shqipërinë, për t'i bllokuar automjetet që dalin jashtë Kosovës. Njëkohësisht kërkojmë nga Policia e Kosovës që të mos ketë provokime në kauzën tonë për mbrojtjen e qëllimeve", ka thënë Paçarizi.



Shpallet konkursi për drejtor të Doganës së Kosovës



PRISHTINË, 3 GUSHT - Ministria e Financave dhe Transfereve ka shpallur konkurs për pozitën e drejtorit të përgjithshëm të Doganës së Kosovës, i cili do të jetë i hapur deri më 1 shtator. "Ministria e Financave, në përputhje me paragrafin 4, të

nenit 5 të Kodit Doganor dhe të Akcizave në Kosovë nr. 03/L-109, i plotësuar dhe ndryshuar me Ligjin Nr. 04/L-099, Ligjin nr. 04/L-115 dhe me Ligjin nr. 04/L-273, me qëllim të emërimit të drejtorit të përgjithshëm të Doganës së Kosovës, më datë 03.08.2020

shpall konkurs për pozitën drejtor të përgjithshëm të Doganës së Kosovës", është thënë në njoftimin e Ministrisë së Financave dhe Transfereve.

Kjo ministri ka siguruar të gjithë aplikantët për këtë pozitë se i tërë procesi i

rekrutimit do të jetë transparent dhe profesional, si dhe ka inkurajuar kandidatet gra dhe nga komunitetet pakicë që të konkurrojnë. Informacionet rreth aplikimit për këtë pozitë mund të gjenden në uebfaqen e Ministrisë së Financave.

Diskutohet për ankandin publik për energji të ripërtërishme



Ankandi publik për energji të ripërtërishme ka qenë temë diskutimi në mes të ministrit të Ekonomisë dhe Ambientit (MEA), Blerim Kuçi dhe udhëheqësit të Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Kosovë (BERZh), Neil Taylor, i cili ka vlerësuar se ky ankand është shumë i rëndësishëm. Ai ka treguar se ky proces do të jetë i suksesshëm, pas përvojës së njëjtë që kanë pasur në Shqipëri

Shqipëri. Taylori ka prezantuar edhe Andreas Gunstin si ekspert i angazhuar për çështjen e ankandit publik për energji të ripërtërishme. Ndërsa ministri Blerim Kuçi ka falënderuar BERZh-in për këtë asistencë, teksa ka konfirmuar angazhimin e tij për procesin e ankandit publik për energji të ripërtërishme. "Ky proces ka filluar nga ministrat paraprakë dhe unë natyrisht se do ta vazhdoj. Për ne është shumë i rëndësishëm liberalizimi i tregut të energjisë dhe ne do t'i vazhdojmë këto procedura. Ajo që neve na bën të ndihemi të

sigurt është përvoja e BERZh-it në një proces të njëjtë. Po e konfirmoj se do t'i bëjmë të gjitha punët për liberalizimin e tregut dhe tregun konkurrues për energji të ripërtërishme", ka thënë Kuçi. Më tutje, ministri Kuçi ua ka bërë me dije BERZh-it dhe ekipit të konsulencës se duhet të bëhet një identifikim i shpejtë i bazës ligjore, pasi ndryshimet në bazën ligjore marrin kohë për ndryshime, pasi kalojnë nëpërmjet Kuvendit të Kosovës. Pjesë e kësaj punëtorie ishte edhe Zyra e Rregullatorit për Energji (ZRE).

EPOKA
ERE

A. MAVRAJ

PRISHTINË, 3 GUSHT - Në Ministrinë e Ekonomisë dhe Ambientit (MEA) është mbajtur një punëtori virtuale me Bankën Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim

(BERZh). Pjesë e kësaj punëtorie ishte ministri Blerim Kuçi me ekipin e këshilltarëve dhe Departamenti i Energjisë, i kryesuar nga udhëheqësi i këtij departamenti, Luan Morina. Tema e punëtorisë mes MEA-së dhe BERZh-it ishte asistencë për ankandin publik për

energji të ripërtërishme. Udhëheqësi i Bankës Evropiane për Rindërtim dhe Zhvillim për Kosovë, Neil Taylor, ka vlerësuar se ky ankand është i rëndësishëm dhe ka treguar se ky proces do të jetë i suksesshëm pas përvojës së njëjtë që kanë pasur në

Kërkohet nga bizneset t'i zbatojnë masat anti-Covid

PRISHTINË, 3 GUSHT (ER) - Ministri i Shëndetësisë (MSh), Armend Zemaj, ka prituri në takim kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës (OEK), Berat Rukiqi. Zemaj ka kërkuar nga Rukiqi që bizneset të bashkëpunojnë për zbatimin e masave të caktuara nga Qeveria e Kosovës. "Në takim me kryetarin e Odës Ekonomike të Kosovës, z. Berat Rukiqi, ofrova përkrahjen e Ministrisë së Shëndetësisë për ekonominë

në vend dhe kërkova bashkëpunimin e bizneseve dhe zbatimin strikt të masave të caktuara nga Qeveria e Kosovës. Rukiqi ofroi përkrahjen e Odës Ekonomike të Kosovës për projektet të cilat kontribuojnë në parandalimin e Covid-19. Bashkë u zotuar se do ta thellojmë edhe më tutje bashkëpunimin mes Ministrisë së Shëndetësisë dhe Odës Ekonomike të Kosovës", ka shkruar Zemaj në llogarinë e vet në "Facebook".



Nderohet ish-komandant "Roki"

KAMENICË, 3 GUSHT (ER) - Nën kryetari i Kamenicës, Faton Jakupi, së bashku me familjarë të komandant Rahim Beqirit dhe zyrtarë të tjerë komunalë, kanë nderuar luftëtarin Beqiri, duke bërë homazhe te varri i tij në 19-vjetorin e rënies së tij. Në këto homazhe të pranishëm ishin edhe kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, nënkryetari Ahmeti Isufi dhe zyrtarë të tjerë. Me këtë rast, nënkryetari Jakupi ka thënë se kontributi i komandant Beqirit për lirinë mbetet i paharruar. "Komandant Rahim Beqiri mbetet një ndër luftëtarët që dha mjaft shumë për atdheun. Edhe jetën. Do

ta kujtojmë përherë si luftëtar trim", ka thënë Jakupi.

Ndërsa kryetari i AAK-së, Ramush Haradinaj, ka thënë se trimat si komandant "Roki" nuk harrohen. "Trimat si komandant 'Roki' e bënë krenarë tërë kombin, i cili u formësua nga heroizmi i tyre. Kujtimi për të mbetet i pashuar", ka thënë ai.

Po në këto homazhe Haradinaj ia ka ndarë medaljen "Me besim në Zot, atdhe e shtet", Liridon Beqirit, birin e komandant "Rokit" për kontributin e veçantë të familjes Beqiri dhënë për lirinë e vendit dhe ndërtimit të paqes.



Pandemia ndikon në të hyrat vetjake të Komunës së Mitrovicës



MITROVICË, 3 GUSHT (ER) - Drejtuar nga kryetari i Komunës së Mitrovicës, Agim Bahtiri, në prani të nënkryetarit Faruk Mujka, të hënën është mbajtur mbledhja e radhës e Bordit të Drejtorëve, ku janë diskutuar disa çështje me interes për qytetarët e kësaj komune. Fillimisht drejtori për Financa dhe Zhvillim Ekonomik, Shukri Gashi, ka kërkuar nga drejtorët komunalë t'i përmbahen planit të veprimit të të gjeturave të auditorëve për vitet 2018 dhe 2019. Po

ashtu, ai ka prezantuar para ekzekutivit raportin financiar për gjashtëmujorin e parë të vitit 2020, të hyrat vetjake, shpaltosjen e buxhetit dhe shpenzimeve, investimet kapitale, si dhe obligimet e papaguara. Drejtori Gashi lidhur me inkasimin e të hyrave vetjake për gjashtëmujorin e parë të këtij viti ka thënë se për shkak të situatës me pandeminë Covid-19, Komuna e Mitrovicës ka ngecje në inkasimin e të hyrave vetjake, me ç'rast ka arritur të inkasojë

63.60 për qind të planifikimit gjatë kësaj periudhe. Me këtë rast, ai ka kërkuar nga drejtorët për gjysmën e dytë të vitit ta japin maksimumin për rritjen e inkasimit të të hyrave vetjake në mënyrë që përqindja të jetë më e lartë. Në fund ai ka shpalosur edhe raportin e dëgjimeve buxhetore për planifikimin e buxhetit për vitin 2021-2023, ku për këtë vit janë mbajtur gjithsej nëntë dëgjime buxhetore dhe pjesëmarrja e qytetarëve ka qenë e kënaqshme.

Komuna e Malishevës vazhdon të punojë me staf të shkurtuar

MALISHEVË, 3 GUSHT (ER) - Kryetari i Komunës së Malishevës, Ragip Begaj, ka mbajtur të hënën mbledhjen e rregullt të Këshillit të Drejtorëve por, për dallim prej herëve të tjera, këtë mbledhje e ka mbajtur duke zhvilluar takim me secilin drejtor veç e veç. Kjo është bërë për shkak të situatës së krijuar në vend nga pandemia Covid-19. Në këto takime drejtorët e drejtorive kanë raportuar për punët dhe aktivitetet e zhvilluara gjatë

javës së kaluar dhe planifikimet për këtë javë, por temë kryesore mbetet situata me pandeminë dhe menaxhimi i kësaj situatë.

Bazuar në raportimet e drejtorëve, drejtoritë komunale janë duke punuar me staf të reduktuar, por të gjitha shërbimet janë duke u kryer pa problem dhe nuk është regjistruar asnjë ankesë në kryerjen e shërbimeve. "Po ashtu, drejtorët kanë raportuar për projektet që janë duke

vazhduar dhe për ato që janë në procedurë e sipër, si dhe për përgatitjet e tjera në secilin sektor përkatës.

Ndonëse me staf të reduktuar, puna dhe aktivitetet e komunës do të vazhdojnë të kryhen pa probleme, po ashtu edhe implementimi i projekteve do të vazhdojë sipas planifikimeve, pavarësisht prej vonesave që janë shkaktuar si pasojë e situatës me pandeminë", ka njoftuar Komuna e Malishevës.



"Jetimat e Ballkanit" ndajnë mish për 300 familje suharekase

SUHAREKË, 3 GUSHT (ER) - Shoqata humanitare "Jetimat e Ballkanit" ka ndarë nga pesë kilogramë mish për 300 familje të Suharekës të cilat janë në gjendje jo të mirë sociale. Me këtë rast, kryetari i Suharekës, Bali Muharremaj, ka falënderuar

Shoqatën "Jetimat e Ballkanit" për ndihmën e dhënë. "E falënderoj Shoqatën 'Jetimat e Ballkanit' e cila ndau nga 5 kg mish për 300 familje të rasteve sociale, të cilat janë shpërndarë sipas listave të Qendrës për Punë Sociale në Suharekë", ka

thënë Muharremaj. Shoqata "Jetimat e Ballkanit", e cila drejtohet nga humanisti Halil Kastrati, në vazhdimësi është duke u dalë në ndihmë familjeve në nevojë, jo vetëm në Kosovë, por në të gjitha trevat ku jetojnë shqiptarët.

SERBIA E KTHEN SHIKIMINPRAPA TEK UÇK-ja, PASI AJO I KA SHKAKTUAR MË SHUMË DHIMBJE (22)



Shkruan: Kudusi LAMA

“Veprimtaritë me prioritet të pjesëtarëve të këtyre grupeve në funksion janë frikësimet e popullsisë serbe dhe të spastrimit etnik të territorit të Kosovë-Matohisë, likuidimin e dëshmitarëve potencialë për akuzat eventuale të Hagës kundër terroristëve shqiptarë dhe eliminimin e kundërshtarëve politikë dhe të bashkëpunëtorëve të tyre”.¹

Po të kishte një veprimtari të tillë në Kosovë pas luftës çlirimtare, nuk do të kishte sot serbë në Kosovë. Por shqiptarët janë qytetarë modernë, ata nuk kryejnë asnjë veprim denigrues e shfarosës ndaj atyre që qëndrojnë në të drejtën e tyre, qofshin ata edhe serbë.

Por në gjithë këtë fjalologji Serbia do të bënte mirë të thoshte si e shpërnguli nga shtëpitë e tyre 75 për qind të popullit shqiptar në vitin 1999. Kështu ndoshta do të detyrohej të bënte në një mënyrë një kërkim faljeje publike për veprën e saj masakruese ndaj një kombi të tërë. E sa u përket likuidimeve, nuk mund të flitet në erë, pasi Kosova është një shtet demokratik dhe shumëllojshmëria e ideve politike për ndërtimin dhe zhvillimin e vendit duke përmirësuar në vazhdimësi jetën e popullit është kusht i demokracisë që po ndërtohet në Kosovë. Njëkohësisht duhet ditur se edhe serbët e Kosovës kanë krijuar një tufë me parti politike dhe nuk po i shqetëson askush. Por dihet qëllimi i deklarimeve të tilla, nëpër të cilat synohet të krijohen parakushte për konflikte politike në Kosovë. Megjithatë kam kuptuar se shpifje të tilla nuk kanë luajtur asnjë rol në Kosovë, pasi aty të gjithë e dinë se çfarë bëjnë dhe mund të thuhet se atmosfera politike më harmonike se në Kosovë në pak vende është në Evropë.

Fatkeqësia qëndron në mashtrimin e opinionit ndërkombëtar, që nuk e njeh gjendjen e vërtetë në Kosovë, e nëpërmjet këtyre deklarimeve të gënjeshtërtë krijon mendim të gabuar se dukuri të tilla mund të jenë të vërteta. Pa folur pastaj

kur gjendet edhe ndonjë megafon keqdashës, si zotëri Marty, që i përforcojnë këto tullumbace të toksike që i hedhë Serbia në qiellin shqiptar për ta ndyrë e helmuar.

“Veçanërisht janë vërejtur veprimtaritë e grupeve që quhen: ‘Ideal’, ‘Skifteri’, ‘BIA’, ‘Kështjella’, ‘Shqiponjat e Mëdha’, ‘Dora e zezë’, ‘Syri i Shqiponjës’, ‘Shqiponjat e Zeza’, ‘Tigrat e Zinj’, ‘Maskat e Zeza’, ‘Zjarri’, ‘Akatana’, ‘Siguria e Vendit’, ‘Siguria e Atdheut’, ‘Flamur Kombëtar’, etj.”²

Duke përmendur emërtime të tilla pas përfundimit të luftës në Kosovë, Serbia duket sikur kërkon të bëjë barazimin me emërtimet e njësive kriminale paramilitare të saj që kanë vepruar në Kosovë gjatë luftës. Por nuk mund të bëhet barasvlefshmëri e tillë, pasi ky popull i ka përjetuar me tmerr veprimet e tyre dhe masakrat që ata kanë kryer mbi këtë popull për gjatë gjithë periudhës së luftës. Kurse UÇK-ja nuk kishte pse të ngrinte struktura luftarake pasi lufta kishte përfunduar. Të gjithë emrat e njësive kriminale është mirë Serbia t’i adresojë atje ku edhe sot vepron, në zonat ku bën akoma krime dhe terrorizëm, ku banojnë serbët si qytetarë të Kosovës së çliruar, sepse prej shqiptarëve popullit shqiptar e di mirë nëse kanë vepruar apo jo njësi të tilla. “Shfaqja e pjesëtarëve të UKSH në mjediset fshatare të kujton daljen në skenë të anëtarëve të UÇK-së gjatë viteve 1996 e 1997, kur me metodat e frikësimit, kurse më vonë edhe me likuidime, e imponuan popullsinë shqiptare që t’iu bashkoheshin masivisht atyre”.³

Duke bërë një deklaram vlerësues, për Armatën Kombëtare Shqiptare, një strukturë që u deklarua në vitin 2002, për të mbrojtur fitoret e arritura nga Ushtritë çlirimtare të mëparshme dhe avancuar ato më tej, Serbia e kthen shikimin prapa tek Ushtria Çlirimtare e Kosovës, pasi vërtetë ajo i ka shkaktuar më shumë dhimbje. Dhe prapë i kthehet për t’i përforcuar metodave të frikësimit e të imponimit që i paska bërë UÇK-ja popullit shqiptar që të dalë në luftë kundër Serbisë. Nuk e di vërtetë mendon Serbia se ka ndonjë shqiptar që do të pranonte të ishte nën sundimin e saj? Nëse vërtetë mendon kështu, do të ndihesha i habitur dhe do të vlerësoja se Serbia nuk

korrigjohet e do të apeloja për të gjithë shqiptarët që të rritin vigjilencën ndaj Serbisë se megjithëse jashtë Kosovës, mbetet e rrezikshme si dje kur na kishte nën sundim kolonial.

“Dhuna në Kosovë - Metohi kryhet për motive etnike, politike dhe ekonomike. Më të shumta në numër dhe më të pa skrupuj janë sulmet e shqiptarëve mbi serbët dhe malazezët të kryera për shkak të urrejtjes nacionale, me qëllim të spastrimit etnik. Është e dukshme se një numër i madh i këtyre krimeve është kryer me plan dhe që rezultatet e hetimeve shpesh kanë treguar për ndërhyrjen e UÇK-së, përkatësisht tani të UKSH-së, por që një numër i vogël vepruesish është zbuluar, siç kanë pohuar në njoftimet e tyre edhe përfaqësuesit e OSBE-së në Prishtinë. (Në mesin e vitit 2003, mediet perëndimore kanë vërejtur se nga qershori 1999 numrin më të madh të sulmeve terroriste e kanë filluar ekstremistët shqiptarë mbi serbët dhe pjesëtarët e pakicave të tjera etnike. Rezultati është dëbimi i pothuaj 240.000 joshqiptarëve nga Kosovë - Metohia, ndërsa pjesëtarët e pakicave që mbetën në Krahinë u grupuan në enklavat e izoluar).”⁴

Unë duke lexuar këtë citim kam dëshirë të pyes publikisht çdo njeri që njeh gjendjen: A ka sot serb që nuk është në shtëpinë e tij në Kosovë dhe a ka shqiptarë që nuk është në shtëpinë e tij në Kosovë?

Sepse sot, në Kosovë të gjithë serbët janë në shtëpitë e tyre, janë në pronën e tyre, shkojnë në rrugën ku shkojnë të gjithë, punojnë në punën e tyre, kanë pushtetin e tyre dhe askush nuk i ngacmon. Mund edhe të ketë të larguar por me sa shihet, janë të larguar ata serbë e malazezë që u sollën nga Bosnje - Hercegovina, Kroacia e Serbia gjatë luftërave të pas vitit 1990. Të cilët u sollën masivisht në Kosovë e natyrisht edhe unë po të isha njeri prej tyre, pas largimit të Serbisë nuk do të qëndroja si kolonë në një shtet të huaj. Ndërsa edhe sot ka shqiptarë, që prej presionit të serbëve nuk kanë shkuar në shtëpitë dhe pronat e tyre megjithëse lufta ka përfunduar prej mbi 20 vjetësh. Unë këtë e konsideroj shqetësim, por ky fakt nuk përmendet as në fjalorin e Serbisë e as të Dick Martyt. Nëse serbët kanë shqetësime se duan Serbinë në Kosovë, ta kuptojnë njëherë e

mirë që përjetësisht kjo s’ka për të ndodhur më. Për këtë të jetë i sigurt edhe zotëri Marty me gjithë raportin e tij antishqiptar në emër të Këshillit të Evropës.

“Në periudhën nga ardhja e forcave Ndërkombëtare në Kosovë - Metohi deri në 23 gusht të vitit 2003, terroristët shqiptar kryen në territorin e Krahinës dhe në komunat e Preshevës e Medvegjës gjithsej 6.571 sulme, nga të cilat 5.962 mbi serbët e malazezët, 207 mbi shqiptarët 335 mbi personat e kombësive të tjera. Në të njëjtën periudhë mbi pjesëtarët e policisë janë kryer 57, kurse mbi përfaqësuesit e ushtrisë së Serbisë - Malit të Zi gjithsej 10 Sulme. Në këtë rast janë vrarë 1.206 persona dhe janë plagosur 1.319 qytetarë dhe 15 policë. Fati i 846 vetave, nga gjithsej 1.146 persona të rrëmbyer, deri tani nuk dihet”.⁵ Lexojeni këtë paragraf për të kuptuar se si përzihen ngjarjet dhe territoret për të sjellë një emërues të përbashkët - emrin e UÇK-së. Me ardhjen e forcave ndërkombëtare në Kosovë a kishte më ushtri e polici serbe që të bëheshin sulme ndaj tyre? Gjithkush e di se nuk kishte dhe praktikisht sulme të tilla ishin të pa mundura, pasi forcat shqiptare nuk janë futur asnjëherë në territore përtej kufijve të Kosovës. Ndërsa në qoftë se flitet për Ushtrinë Çlirimtare Preshevë - Medvegjë - Bujanovë, dihet që Serbia me këtë ushtri me prezencë ndërkombëtare ka nënshkruar një marrëveshje paqeje. Marrëveshje që nga pozitat e të fortit deri tani nuk e ka zbatuar. Ashtu sikurse është nënshkruar edhe një marrëveshje paqeje në Ohër me Ushtrinë Çlirimtare Kombëtare nga shtetin i Maqedonisë, e cila gjithashtu akoma mbetet e pa implementuar.

Këto janë veprimtari në kuadër të lëvizjes kombëtare dhe unë mendoj se lëvizja kombëtare edhe pas këtyre nuk duhet të ndalet deri në zgjidhjen përfundimtare të çështjes shqiptare e bashkimin e të gjithë shqiptarëve e trojeve të tyre në një shtet të vetëm kombëtar. Dhe shikoni që Serbia për ato çfarë i intereson të ngrejë shpifje paska evidenca të çuditshme, kurse për rreth 2 mijë të zhdukurit shqiptar nuk ka evidencë, që është një tregues i fuqishëm i prezencës së mashtrimit dhe shpifjes kundërshqiptare me qëllime të caktuara, siç duket si instruksion për zotëri Martyn, që të ketë

material të bollshëm për raportin.

“Veçanërisht shqetësuese është tendenca e rritjes së numrit të vrasjeve të shqiptarëve që janë në listë dëshmitarë ose që kanë dëshmuar kundër pjesëtarëve të paditur të UÇK-së”.⁶

Paragrafi i cituar më lartë është një ideologji të cilën Serbia nuk e përdorë për herë të parë. Kjo është ideologjia që ka përdorur gjatë gjithë hapësirës kohore të pushtimit. Sepse gjithnjë është përpjekur të ngulit tek të gjithë shqiptarët, idenë që rreziku i shqiptarëve janë shqiptarët; që shqiptarët i bëjnë vetëm keq njëri tjetrit; që shqiptarët duhet të jenë vigjilent ndaj rrezikshmërisë që paraqesin ndërmjet vetes; që shqiptarët janë hakmarrës dhe të egër me njëri tjetrin; që shqiptarët po u prishe interesat e tyre të likuidojnë etj. Të gjitha këto ne i njohim dhe e dimë që Serbia atë program ka, sepse vetëm ashtu mund ta mbante të sunduar Kosovën dhe të mbajë viset e tjera të pushtuara, duke përçarë shqiptarët në mënyra nga më monstruozet. Por që këtë fjali e përdorë edhe Dick Marty në raportin e tij, kjo të duket pak interesant, pasi nuk ndalet vetëm me akuza për vepra të kryera por edhe me paramendime se çfarë mund të ndodh në qoftë se këto akte dalin në dritë.

“Ekspansioni i krimit të organizuar në Kosovë - Metohi është pasojë e drejtpërdrejtë e veprimtarive terroriste të UÇK-së, disa udhëheqës të së cilës kanë shfrytëzuar autoritetin në këtë organizatë për të vendosur kontrollin mbi tregtinë ilegale në zonën e vet të kompetencave (para)ushtarake”.⁷ (Vijon)

¹ Obiliç, Millosh, “Engjëjt e zinj të skëtërrës kosovare”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 17, botimi serbisht

² Po aty faqe 17

³ Obiliç, Millosh, “Engjëjt e zinj të skëtërrës kosovare”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 20, botimi serbisht

⁴ Po aty faqe 21

⁵ Obiliç, Millosh, “Engjëjt e zinj të skëtërrës kosovare”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 21, botimi serbisht

⁶ Obiliç, Millosh, “Engjëjt e zinj të skëtërrës kosovare”, dosjet “sekrete”, Beograd, 2004, faqe 22, botimi serbisht

⁷ Po aty faqe 28



Kur trupin tim e kanë bërë pothuajse një kufomë, atëherë mendimi ka fituar lirinë

Nga: Fatmira NIKOLLI

Vloçisht, 1948. Tri baraka të mbuluara me mushama, vende-vende të shpuara strehojnë nga 1300 deri në 1600 të burgosur. Brenda tyre vjen erë e rëndë. Krevetet kanë vetëm nga tri dërrasa. Është korrik kur një djalosh 28-vjeçar u bashkohet aty të dënuarve që kanë tre muaj në kamp. Quhet Arshi Pipa dhe nuk njihet asnjë. Prej mundimeve e urisë, portretet e tyre i kanë humbur tiparet. Të dënuarit, nuk kanë mundësi të lahen a të pastrohen, ka për të gjithë vetëm një pus, ndërsa ujë të pijshëm, fare pak. Janë bashkë të dënuarit politikë e ata për krime ordinere. Këta të fundit mbahen më mirë se intelektualët, sepse cilësohen proletarë. Ka shumë raste vjedhjesh dhe dënohen ata që ankohen, më shumë se sa ata që vjedhin. Ushqimi në kamp është i pakët, të burgosurit punojnë larg, dhe kur shohin ara me misër vrapojnë të marrin ndonjë kallë e ta hanë edhe pse rojet i godasin me shkelma kokës. Nuk kanë këpucë e çizme, shpesh ecin

zbathur, shkojnë larg për të hapur kanale, ndaj këmbët u enjten dhe shpesh, vdesin shpejt.

Arshi Pipa i mban këto shënime fshehurazi, në letra cigareje. Jeta e tij është thyer në mes dhe ai e dokumenton atë. Kishte qenë profesor, filozof, kritik, poet, por kohët e lirisë dhe vetë fëmijëria tashmë janë të largëta.

Kishte lindur në një familje të mirë. I ati, Mustafai nga Libohova ishte gjyqtar i shkolluar në Stamboll; ishte njohur e martuar me Hatixhenë dhe qenë vendosur në qytetin e saj në Shkodër. Kishin dy djem e katër vajza. Arshiun e patën dërguar të merrte mësimet e para në Kolegjin e Jezuitëve, ku për vetësoi herët greqishten e vjetër e latinishten, gjuhët që e shoqëruan gjithë jetën, siç na dëshmojnë sot përkthimet e lëna në dorëshkrim. Shumë i lidhur me familjen e tij të madhe, nga të gjithë veçonte të vëllanë, Muzaferin, e ndërsa ai kishte nisur studimet për jurisprudencë në Padova të Italisë, Arshiu më 1938 shkoi në Firence për Letërsi e Filozofi. I rregullt në shkollë e i dhënë pas mësimëve, rioshi e

shfrytëzonte edhe kohën e lirë për të lexuar. “Nuk kemi ardhë këtu për ahengje e dafrungë, por për më studjue. Dhe më parë se gjithshka asht detyra. E detyra jonë asht studimi e mbarimi i universitetit!”, u thoshte ai miqve kur e ftonin të dilte.

Arshi Pipa ishte në vitin e dytë të studimeve, kur nisi lufta dhe Shqipëria u pushtua. Më 1941 kur kthehej, vendi kontrollohej nga fashistët dhe grupet e rezistencës qenë ngritur. I vëllai ishte arrestuar, sepse pat kundërshtuar pushtimin dhe ishte internuar në ishullin famëkeq Ventotene më 1940 si shumë shqiptarë të tjerë. Në këto kohë të vështira për familjen, ai zgjedh të rrijë me të, i tërhequr nga lufta dhe të ndërtojë profilin e tij intelektual. Punon një vit mësues në Gjimnazin e Tiranës, përgatit tezën e diplomës për filozofin frëng, Henri Bergson, punon në gjimnazin e Shkodrës dhe më pas vendoset me gjithë familjen në Tiranë.

Në kryeqytet, më 1944 Pipa themelon revistën “Kritika” që doli katër numra me synim nxitjen e kritikës letrare në Shqipëri, pasi është konsultuar

me dijetarin Aleks Buda siç del nga një letër e 23 marsit që ruhet në arkivin e familjes Buda. “Gjithsesi nuk besoj t’ia kem dalë plotësisht”, i shkruan profesorit, “por mendoj se në numrin i dytë do të jetë më i pasur dhe i ndryshëm”.

Internimi i vëllait ishte vetëm një arsye pse Pipa nuk u angazhua në Lëvizjen Nacionalçlirimtare, kundërshtimi i modelit totalitar dhe filozofisë marksiste ishte arsyeja tjetër. “Jam rritur në një familje që mund të konsiderohet demokratike, me urrejtje për diktaturën e çfardo tipi qoftë ajo”, do të shprehej ai në një intervistë të pas 1990-ës ku tregonte se i kishte lexuar Marks, Lenin, Gramshin, Stalinin dhe se e njihte ideologjinë e tyre. Djaloshi i diplomuar në filozofi, i dhënë pas Spinozës e Kantit, i cilësonte të papërfillshëm ideologët marksistë. Madje, për Stalinin mendonte se qe pa ndonjë farë niveli, ndaj imponimi i stalinizmit në Shqipëri e mbante larg nga lufta e udhëheqësit e saj. E ndonëse i ishte propozuar të bëhej pjesë e lëvizjes nacionalçlirimtare, nuk pranoi.

Në mbarim të luftës, Arshi Pipa ishte profesor e pjesë e Institutit të Studimeve, kur Partia Komuniste bëhet vendimmarrëse dhe nis goditjen e kundërshtarëve. Çështja e parë e bujshme ishte i famshmi “Gjyq i Deputetëve” ku u dënuan politikanë elite që kërkonin vendosjen e një sistemi demokratik qeverisjeje. Avokat i tyre ishte caktuar Muzafer Pipa, që për shkak të padrejtësive që po bëheshin në gjyq, pati përplasje me gjykatësin. Vëllai i Arshiut më tej mbrojti në gjyq edhe klerikët katolikë, çka shënoi fundin e tij. Është viti 1946 dhe vetë Arshi Pipa është vënë në survejim, ai nuk e di dhe e kundërshton regjimin në disa mënyra. Një ligjëratë për Migjenin, poetin e mjerimit, një koment mbi poezinë e Faustit “Kënga e Plebishtit”, janë cilësuar si akte rebelimi dhe ai ulet në detyrë e dërgohet në Durrës si mësues, ku çdo lëvizje e Arshiut i raportohet Sigurimit të Shtetit nga një student i tij, i cili madje e provokon duke e pyetur për Majakovskin dhe për Stalinin, për të cilët Arshiu flet pa vlerësim.

Kulmi shënohet në një

mbrëmje letrare, ku një prej recituesve flet për ndërtimin e një fabrike. “Do e ndërtojmë me slogane”, thotë me ironi një djalë në të djathtë të tij, Arshiu qesh në shenjë aprovimi dhe teksa një poezi patetike interpretohej, zhvillohet një dialog parodizues buzëqeshesh dhe ironish. Në fund ata përshëndeten, djaloşi ikën dhe vetëm më pas, Arshiu mëson se e kish përqeshur sistemin me Nako Spiron, një prej drejtuesve komunistë. “Rebelimi” i tij dhe qëndrimi i të vëllait në gjyqin kundër deputetëve bëjnë që Arshiu të arrestohet në prill të 1946-ës.

E akuzojnë për veprimtari kundër pushtetit me grupe tradhtare dhe në nëntor e dënojnë me dy vjet burg në Durrës. Sipas një studimi të Andi Pinarit e Indrit Qehajaj, mbi të cilin bazohet ky artikull, dënimi ishte arbitrar, çka pranohet më vonë edhe nga hetuesit. Por, ndërsa ai vuante dënimin, hetimi për të vijon dhe një dokument i 5 dhjetorit 1947 e cilëson dënimin e parë minimal, me argumentin se autoritetet nuk kanë pasur prova të mjaftueshme. Me pretendimin se ende nuk ishte zbuluar thellësisht organizata tradhtare-sabotore e deputetëve ku ai bënte pjesë, duke i shtuar akuzës edhe vëllai Muzaferin si tradhtar dhe armik i popullit, bëhet një proces i dytë gjyqësor.

Ka një lum akuzash për të: pjesë e organizatës socialdemokrate, i lidhur me klerikët dhe partitë tradhtare të Ballit Kombëtar dhe Lëvizjes së Legalitetit, kundërshtar i reformave e sabotator në sektorin e librit shkollor, propagandues i një ndërhyrje të armatosur nga anglo-amerikanët që do rrëzonin

pushtetin, drejtues revistash fashiste. Akuzohet që bënte mbledhje të rregullta në Liceun e Tiranës, se i mblidhte studentët në shtëpinë e tij për t’u bërë propagandë kundër pushtetit, që u thoshte se pushteti ishte shtypës e terrorist, se reformat po shkatërrojnë vendin dhe po varfërojnë popullin e se në drejtim janë vendosur njerëz të paftë.

Pipa nuk i pranon akuzat. Mohon të ketë pasur dijeni për një organizatë kundra pushtetit e përgënjeshtrore deklarimet e dëshmitarëve. “Pakënaqësitë e mia ndaj pushtetit popullor unë i kam shprehur dhe janë të njohura”, shprehet Arshiu dhe kërkon ballafaqim, pasi ndonjë prej dëshmitarëve as e njeh fare, e me disa të tjerë ka folur vetëm për çështje letrare e jo politike. Thotë se studentëve u ka dhënë mësim privat dhe mbase nuk i kanë kuptuar fjalët e tij.

Për Arshi Pipën kërkohej dënim maksimal, por ai nuk i pranon krimet për të cilat akuzohet. Hetuesi e kërcënon se do të përfundojë si i vëllai nëse nuk dëshmon çfarë i kërkohet. Arshiu e merr vesh në këtë mënyrë vdekjen e Muzaferit tre muaj më pas. Ishte arrestuar dhe kishte humbur jetën në tortura. Për të mbuluar krimin, e kishin hedhur nga dritaret e ndërtesës ku zhvilloheshin hetimet në Shkodër dhe vdekjen e kishin mbuluar si tentativë arratisjeje. Të motrat nuk kishin mundur t’ia thoshin, sepse e dinin sa e donte Arshiu të vëllanë dhe ishin të vetëdijshme për shëndetin e dobët të tij.

Më 20 dhjetor 1947 Arshi Pipa ridënohet nga Gjykata me 20 vite burg. Shkruan një elegji për të vëllanë, ku e pranon vdekjen e tij dhe betohet të gjejë forcë.

Në Vloçisht, kushtet e këqija të burgut i vuan më shumë për shkak të inflacionit në mushkëri. Sheh se fshatarët e dënuar shihen me më pak përcmim se intelektualë si ai. Ndaj shpesh, intelektualët vishen si fshatarë për t’i shpëtuar dhunës. Kampi i Vloçishtit i duket një kamp shfarosjeje!

Përfiton nga një amnisti e Enver Hoxhës më 1949 dhe i ulen 10 vite burg. Pas një viti në kamp, sëmundja i rëndohet dhe shtrohet në spitalin e burgut në Durrës (1950). E dërgojnë në burgun e Gjirokastrës (1952), më pas në burgun e Tiranës. Sëmuret sërisht. Shtrohet sërisht në spitalin e burgut. Kohë më vonë e çojnë në burgun e Burrelit, ndër më të tmerrshmit e kohës. Aty ka vetëm një pus, por të burgosurit nuk kanë me se ta marrin ujin, nuk u jepet enë, as kovë, as litar. Përdorin ç’të munden për ta nxjerrë, por është i ndotur. Shpesh herë del me krimba. Të burgosurit sëmuren, qindra prej tyre gjejnë vdekjen. Shtrirë në një dyshek të shtruar në çimento, në një fletore ku shihej portreti i Stalinit, shkruan një vepër filozofike. “A do të kisha imagjinuar ndonjëherë që njeriu, kjo qenie që Zoti e krijoi sipas shëmbëlltyrës së vet, mund të jetë kaq afër kafshës? Tashti po e kuptoja se ç’domethënie kishin ato hyjni pagane, gjysmë njeri e gjysmë kafshë, si centaurët e sirenat! Në burg kam njohur gjithë poshtërsinë e njeriut, gjithçka që është trashëgim shtazor tek ai, nga egoizmi i egër që arrin të urojë vdekjen e shokut për t’i vjedhur bukën, te frika e marrë shtazore që errëson jo vetëm arsyen, por deri edhe ndjenjat”. E shkruan në gjuhën italiane “Skicën e një konceptimi mbi


jetën plotësuar me mbigjenin” prej ku janë shkëputur fjalitë, sepse gardianët nuk do e kuptonin gjuhën, nëse arrinin t’ia gjenin.

I dobët dhe i sëmurë, arrin të dalë i gjallë prej aty në prill të 1956-ës. Ka ruajtur shënimet e 10 viteve të veta në burgje në letra cigaresh. I ka nxjerrë nga burgju të fshehura në rrobat e palara. Ndërsa veprën e filozofike e nxjerr të fshehur në një dyshek të vjetër që rojave nuk u shkon në mendje ta kontrollojnë.

Rreket të shijojë lirinë me të ëmën e motrat. Mendon se vuajtjet mbaruan, por e kupton që nuk është krejt e vërtetë. Si ish-i burgosur ka vështirësi të gjejë punë. Të tjerëve u jepeshin punë fizike, por ai është i dobët e i pafuqi. Pas shumë mundimesh e caktojnë mësues në një shkollë shtatëvjeçare në Shkodër, por kjo nuk e kënaqte. Kërkon ta lërë punën me pretekstin se është i sëmurë. Sistemi veçse bëhet më i fortë dhe ai vendos të arratiset, bashkë me një nga motrat. Në një libër të studiuesit Uran Kalakula, kushtuar Pipës, shënohet se ai dhe motër Fehimeja, u ndihmuan nga një fshatar që kishte shtëpinë pranë kufirit. Arshiu e kaloi lumin e Bunës me not e matanë bregut e pritë motra. Shkojnë në Muriqan, arrijnë të kalojnë kufirin shqiptar dhe paraqiten pranë postës jugosllave, ku qëndrojnë disa kohë në hetuesi në Tivar. Kanë fat dhe jugosllavët nuk i kthejnë mbrapsht. Lirohen dhe i drejtohen Sarajevës ku ndodhet i fejuari i Fehimes me familjen e tij. Para se të ikin, kanë marrë me vete kujtimet: letrat e cigareve me shënime e motra i kish qepur nëpër rrobat e saj. Gjatë muajve shtator-nëntor 1957 kur janë në Sarajevë i kanë

renditur fletët. Arshi Pipa ëndërron Perëndimin, ndaj ikën së pari në Romë dhe më pas në Amerikë. Atje, pasi mëson gjuhën angleze, nis të ngjisë shkallët e karrierës në universitet. Si fillim jep lëndën e filozofisë dhe filozofinë e fesë e krishterë. Në një dokumentar të Televizionit Publik Shqiptar në vitet 1990, Arshiu shprehet se njohuritë e tij për sa i përket fesë ishin të pakta, vetëm disa gjëra që mbante mend nga Kolegji i Jezuitëve. Arshiu u bë një pedagog mysliman që jepte filozofi të krishterë.

Letrat e cigareve i përgatit dhe i bën libër që botohet në Romë në vitin 1959. E quan “Libri i Burgut” dhe tregon në të vuajtjet dhe torturat. Mundi të rikthehet në atdhe 30 vite më vonë. E, megjithatë, vetëm pas vdekjes së tij, motra tjetër, Nedreti, përkthen nga italishtja dhe boton veprën e tij filozofike, për të njohur më mirë të vëllanë me të cilin jetoi aq pak, sepse ai u arratis e ajo e shkoi jetën në internime. Ai ia doli të bëhej i fortë dhe ia doli të mbetej njeri. Nëse do të pyetej se çfarë i bëri komunizmi Arshi Pipës, përgjigjen do ta gjenim te vepra e tij filozofike të cilën e shkroi në burg. “Kanë prangosur trupin tim, por nuk kanë mundur të prangosin mendimin tim. Dhe – gjë vërtet e mrekullueshme – kur trupin tim e kanë bërë pothuajse një kufomë, atëherë mendimi ka fituar lirinë... Më kanë mbyllur në këtë burg që të vuaj. Unë nuk u mbaj mëri atyre që më kanë bërë të vuaj, madje i falënderoj, dhe sinqerisht. Ka të drejtë të mallkojë vuajtjen ai që shtypet nga ajo. Por, ai që e mund, do të duhej ta bekonte. Ndërsa njëra degjeneron në vuajtje, tjetra ripërtëritet. Poshtë ajo të çon te krimbi, lart te hyjnia...” /GSh/



E rrallë

Fustani i veçantë shumëngjyrësh i nuses



Gjetja e veshjes ideale të dasmës mund të jetë një zgjedhje e vështirë. Diçka e tillë ishte edhe për artisten Taylor Anne Linko, por u kthye në veshjen më të mrekullueshme të nusërisë. Taylor dëshironte që fustani

i saj i dasmës të ishte i paharrueshëm dhe ta përcillte personalitetin e saj shumëngjyrësh. Një javë para ditës së madhe, ajo e hodhi idenë e saj në letër, duke krijuar një fustan nusërie me një shumëllo-

jshmëri ngjyrash në pjesën e fundit të tij. Veshja, gjithashtu, përputhej me ngjyrat në flokët dhe buqetën e saj. Pas publikimit të fotove në rrjetet sociale, fustani i saj i nusërisë është bërë menjëherë viral.

BARSOLETA E DITËS



E dashura: Zemër, a të dukem e bukur?
I dashuri: Ma jep edhe një mundësi tjetër shpirt.
E dashura: Pse?
I dashuri: Jam akoma te gota e parë e "Whisky".



Në Kino ABC nuk ka shfaqje



E jashtëzakonshme

Studimi: Mesazhet mund të shërbejnë si terapi për shëndetin mendor

Një studim i ri i kryer së fundmi tregon se dërgimi i mesazheve mund të jetë një mjet i sigurt dhe mjaft ndihmues për parandalimin e problemeve me shëndetin mendor. Autori i studimit, William J. Hudenko, është shprehur: "Ky studim është shumë emocionues sepse kemi parë përmirësim të vërtetë të gjendjes emocionale pas dërgimit të një mesazhi. Rezultatet janë premtuese dhe ne parashikojmë që është një terapi e mirë për njerëzit që gjenden në një situatë jo të mirë emocionale ose kanë probleme me stresin dhe

depressionin". Ekipi hulumtues ka ekzaminuar ndikimin e mesazheve me tekst tek individë të ndryshëm. Njerëzit me sëmundje të rëndë mendore kanë më shumë mundësi të përjetojnë simptoma çdo ditë, për të cilat mund të kenë nevojë për terapi shtesë. Gjatë studimit janë dërguar mbi 12 mijë mesazhe dhe çdo mesazh është kodifikuar, monitoruar dhe është diskutuar me ekspertët. Një ndërhyrje me bazë mesazhesh konsiderohet si një mënyrë tepër efektive për të ndihmuar në menaxhimin e problemeve të ndryshme me shëndetin mendor.

FOTO E DITES



Një nga çastet më fantastike të perëndimit të diellit në Golem. /LSA/



DASHI

Është periudhë që je pak nervoz dhe duhet të keni kujdes. Do të duhet kohë dhe durim nëse prisni diçka në fushën ligjore.



DEMI

Në këtë periudhë jeni nervoz sa iu përket parave, ndaj duhet kujdes i madh. Ka shumë shpenzime për momentin.



BINJAKËT

Mundohuni t'i shfaqni ndjenjat tuaja, mos i fshihni apo "fikni" ato. Problemet mund të zgjidhen shpejt edhe në punë.



GAFORRJA

Është koha që në dashuri të mos grindeni. Paraja mund të jetë burim shqetësimi. Në punë ndryshimet mund të jenë të nevojshme për të rifilluar përsëri.



LUANI

Në këtë periudhë jeni i shqetësuar pasi keni dyshime në dashuri. Shtoni vëmendjen në punë, dhe përpiquni të përfundoni angazhimet që kishit filluar.



VIRGJËRESHA

Sa i përket dashurisë, është koha që të flisni dhe të bëni përpara nëse pëlqeni dikë. Në punë, kini kujdes nëse po planifikoni ndryshime.



PESHORJA

Mundohuni të jeni të qetë dhe të shmangni diskutimet gjatë kësaj kohe. Problemet në punë nuk duhet t'i shkarkoni në çift. Në punë ka paqartësi.



AKREPI

Duhet të jeni pozitiv pasi negativiteti nuk sjell asgjë të mirë. Në punë diçka nuk po shkon si duhet, një konflikt mund t'ju nervozojë.



SHIGJETARI

Mundohuni ta mbani gjendjen tuaj të qëndrueshme. Në punë duhet të jeni më ngulmues në mënyrë që të bien në pah vlerat e tua.



BRICJAPI

Dashuria duket e lënë disi pas dore, ku kryesisht e keni mendjen te çështjet e punës. Je shumë i lodhur por duhet të rezistosh.



UJORI

Gjeni diçka për tu çlodhur dhe ndryshoni ambient. Një person që ju ka mërzi-tur, tashmë nuk është më problem.



PESHQIT

Më në fund jeni në një periudhë me plot energji, prandaj shfrytëzoheni sa më mirë edhe në dashuri. Lëroni mënjane konfliktet.

Aktori Sean Penn martohet për herë të tretë

Aktori i njohur Sean Penn e ka kurorëzuar dashurinë me martesë, shkruajnë mediat e huaja. Ai është martuar për herë të tretë me aktoren Leila George, e cila është 31 vjet më e re se ai. Sean ka katër vjet që ka filluar takimet me aktoren e cila ka luajtur në filmat “Mortal Engines”, “Jurassic World”, “Vincent D’Onofrio”. Babai i saj është vetëm një vit më i vjetër se aktori. Martesa e tyre sekrete është zbuluar nga Irena Medavoy, gruaja e producentit të “Black Swan”, Mike Medavoy, derisa ka postuar një mesazh urimi në “Instagram”. “Jemi kaq të lumtur që Leila George dhe Sean Penn u martuan”, ka shkruar ajo. Sean ka qenë i martuar më parë me këngëtarën e muzikës pop, Madonna nga 1985 deri në 1989 përpara se të martohej me aktoren Robin Wright. Dyshja kanë qenë të martuar për 14 vjet para se të



divorcoheshin në vitin 2010. Sean ka qenë, po ashtu, i lidhur me aktoren Charlize Theron nga 2013 deri në 2015.

Modeluesja e famshme shfaqet joshëse në bikini



Modeluesja dhe aktorja e famshme Lindsey Pelas vazhdon të jetë aktive në llogarinë e saj në “Instagram”. Fotot dhe videot që i publikon janë shumë të komentuar pasi në to shumicën

e kohës shfaqet provokuese e veshur në bikini. Së fundmi, në videon e postuar në “Instagram” ka provokuar me gjoksin. Më pas kanë ardhur shumë reagime nga ndjekësit e saj.



Kylie “pushton” ballinën e “Vogue”

Kylie Jenner është përsëri vajza që ka pushtuar ballinën e “Vogue” derisa ajo ka pozuar me një fustan të kuq për ta treguar “fuqinë dhe vendosmërinë” në numrin e Hong Kongut. Kylie është dukur jashtëzakonisht bukur derisa ka


pozuar për edicionin e “Vogue Hong Kong”. Afaristja e kozmetikës, 22 vjeçe, ka pasur të veshur një fustan të Yves Saint Laurent, derisa ka bërë foto të nxehta para kamerës. Edhe kësaj here ajo ka treguar se pse është një prej femrave më të njohura në botë.

Beyonce vishet nga kreatorët e njohur shqiptarë edhe në projektin më të ri



Mbretëresha e muzikës pop, Beyonce, pak ditë më parë ka prezantuar filmin e saj “Black is King”. Me këngë të fuqishme dhe performancë të mahnitshme në formën e një albumi vizual, krijuesja e hitit “Run the World (Girls)” bëri një rrëfim të veçantë ku, mes të tjerash, trajtoi

historinë e njerëzve me ngjyrë dhe traditës afrikane. Në projektin madhështor ajo ka bashkuar forcat sërisht me stilistët shqiptarë “Kujta & Meri” dhe kjo nuk është hera e parë. Këta të fundit përmes një postimi të ndarë në “Instagram” kanë treguar se si ishte kjo përvojë për ta.



EURO GLASS
SAINT-GOBAIN SEKURIT PILKINGTON
Enveri
Adr: Fushë Kosovë
Mob: 044 10 20 10 / 049 145 336
E-mail: euro.glass@live.com



QENDRA SPORTIVE
'BUJQËSIA'
TEL: 045/82 82 82

FC Kosova, 'çerdhe' e shqiptarëve në Gjermani



PRISHTINË, 3 GUSHT - Klubi i Futbollit "FC Kosova" u formua në vitin 1999 në Königswinter nga bashkatdhetarët tanë që jetojnë e veprojnë në rrethinën e Su/Bonn. Qëllimi i themelimit të klubit ishte ide e mërgimtarëve që rinisë tonë t'i ofrojë aktivitete sportive edhe që të jemi më afër njëri-tjetrit në organizime. Përveç organizimit të turnirëve, kryesia e klubit organizon edhe përgatitjen e ushqimeve tradicionale shqiptare dhe ofron mundësitë e shoqërimit dhe bashkëpunimit të bashkatdhetarëve duke ofruar kafe e qaj. Pas gjithë vështirësive dhe peripecive nëpër të cilat ka kaluar klubi nga fillimi i formimit të tij, sot ne ndihemi krenarë me kryesinë e udhëhequr nga Mustafë Ademaj kryetar, Fatmir Hamza nënkryetar, Izet Nuradini arkëtar, Adem Saliukaj arkëtar, Haxhi Nuradini anëtar, Kushtrim Ademaj anëtar, Ardijan Berisha anëtar, trajneri Arton Delijaj, dhe stafi tjetër i klubit.

Në vitin 2019 klubi ka festuar 20-vjetorin e themelimit me pjesëmarrjen e një numri bukur të madh të sportdashësve dhe dashamirëve të klubit, rreth 1200 pjesëmarrës, ku kishin edhe dy mysafirë të veçantë, këngëtarët e mirënjohur Shyhrete Behluli dhe Gold Ag (Arjan Agushi).

Përveç aktiviteteve sportive, kryesia e klubit, lojtarët dhe mbështetësit e ekipit kanë organizuar edhe grumbullimin e

ndihmave humanitare për shkollë, persona me nevoja të veçanta, tërmetin në Shqipëri, familjet në nevojë etj. Po ashtu, FC "Kosova" ka ndihmuar edhe në ndërtimin e xhamisë në Troisdorf. Kryesia e klubit ka përgatitur plane edhe për të ardhmen e klubit dhe synimi i tyre është grumbullimi dhe angazhimi i të rinjve në ekip, përgatitja profesionale e tyre, ngritja e klubit në nivele më të larta sportive dhe plasimi i lojtarëve në treg. Se sa do të arrihet në këtë drejtim mbetet të shihet, por kryesia e klubit është duke punuar në këtë drejtim. Deri tani klubi ka qenë mjaft i suksesshëm duke marrë pjesë në liga dhe turnirë të ndryshme edhe gjatë kësaj kohe shihen ngritjet dhe sukseset e tij. Ato suksese janë të prekshme dhe shumë reale. Gjatë periudhës 1999-2002 klubi ka zhvilluar ndeshjet në Kreis Liga C, Königswinter Niderdolandorf. Prej 2002-2017 klubi është transferuar në Menden Sankt Augustin, kurse gjatë sezonit 2017-2018 është transferuar dhe zhvillon ndeshjet në fushën sportive të FC. Augustin në Niederpleis. Gjatë kësaj periudhe klubi kishte suksese të shumta, por më të rëndësishmet janë: Tri herë ishte kampion i Kreisligës C, një herë kampion i Kreisligës B, pesë herë Stadsmeister i Sankt Augustinit në futsal për seniorë dhe juniorë. Aktualisht klubi në gara përfaqësohet nga dy ekipe: njëri në Kreis Ligen B dhe tjetrin Kreis Ligën

C. Ekipi i parë në sezonin 2109/2020 është shpallur kampion dhe është ngritur në Kreis Ligen B, ku do të zhvillojë gara për të avancuar më lart. Për momentin klubi ka një personel prej rreth 70 anëtarësh, përfshirë kryesinë e klubit dhe lojtarët. Gjatë zhvillimit të klubit, përveç lojtarëve shqiptarë, kishte lojtarë edhe të nacionaliteteve të tjera përfshirë turqit, rusët, gjermanët, marokenët, berberët, kurdët, etj. të cilët kanë dhënë kontribut në zhvillimin dhe ngritjen e klubit dhe edhe sot e kësaj dite vazhdojnë ta japin kontributin dhe potencialin e tyre në mbështetjen e klubit. Për këtë, kryesia e klubit u është mirënjohës të gjithë atyre që në çfarëdo mënyre kanë dhënë kontribut dhe vazhdojnë të japin kontribut dhe e mbështesin klubin në rrugëtimin e tij drejt të ardhmes. Ky klub, kompanitë e ndryshme, shoqatat kulturore-artistike dhe organizimet e mira të mërgimtarëve janë shembull i mirë i integritimit të qytetarëve tanë në botën perëndimore, evropiane dhe janë zë i fuqishëm i kombit e i vendit, duke përfaqësuar atë denjësisht jo vetëm në bashkësitë ku jetojnë e veprojnë, por edhe në arenën ndërkombëtare. Si popull dhe si shtet kemi nevojë që gjithmonë të kemi përfaqësues dinjitozë në prezantimin e vlerave kombëtare dhe përshtatjen e tyre me vlerat përparimtare evropiane e botërore.

SHKURT

Dumani largohet nga Flamurtari

Futbollisti Gentrit Dumani e ka zyrtarizuar largimin nga skuadra e Flamurtarit të Prishtinës. "Nga sot nuk jam më pjesë e KF Flamurtari. Falënderoj kryetarin e klubit, Imer Ademi, për korrektësinë. Falënderoj trajnerët dhe bashkëlojtarët. Uroj që Flamurtari të kthehet aty ku e ka vendin në Superligë. Kam kaluar dy vjetët më të mira në karrierë. Respekt nga zemra për këtë klub me traditë dhe suksese", ka shkruar Dumani.

Fillon paraqitja e klubeve për edicionin e ri

Federata e Basketbollit e Kosovës (FBK) njofton të gjitha klubet se nga 1 gushti ka filluar paraqitja e klubeve në të dy konkurrencat, si dhe për kategoritë e reja për edicionin 2020-2021. Afati i paraqitjes së klubeve për edicionin e ri do të vazhdojë deri më 20 gusht, kur është dita e fundit që klubet të regjistrohen. "Klubet, pas plotësimit me të dhëna, i njëjti formular, së bashku me certifikatën e regjistrimit të OJQ-së, duhet ta dërgojnë në adresën elektronike: kome-sari@basketbolli.com", thuhet në njoftimin e FBK-së.

Kumbulla: Duket si ëndërr, udhëtim i jashtëzakonshëm

Marash Kumbulla vijon të jetë në qendër të vëmendjes në merkaton e Serisë A. Mbrojtësi i Kombëtares kuqezi, pas një supersezone te Hellas Verona, është në orbitën e shumë klubeve të mëdha, por Inter dhe Juventus duket se janë më pranë. Në fundmi ai ka bërë një publikim në rrjetet sociale, duke dhënë sinjale lamtumire. "Nëse ndalem për një moment të mendoj për sezonin që sapo ka përfunduar, duket si një ëndërr. Duke filluar nga ajo 25 gusht, data e debutimit në A, të cilën nuk do ta harroj. Ashtu siç me siguri nuk do të mund të harroj 5 tetorin dhe gëzimin e golit të parë. Sfidat për emrat e mëdhenj në kampionatin tonë, fitorja ndaj ekipit kampion të Italisë, udhëtimi i një grupi të jashtëzakonshëm që meritonte çdo pikë të vetme dhe çdo kënaqësi të veçantë të një kampionati për të qenë thjesht krenar", ka thënë Kumbulla.

Gjilani në bisedime me Zhdrellën, Januzin dhe Thaqin

GJILAN, 3 GUSHT - Është një nga ato rastet kur sukcesi ta shton "oreksin". Pas një sezoni të jashtëzakonshëm të cilin e kurorëzoi me daljen në Evropë, Gjilani po punon

vullshëm në afatin kalimtar. Presidenti Florim Zuka dëshiron të krijojë një skuadër të fortë për parakualifikimet e Ligës së Evropës dhe pretendente për titull në edi-

cionin e ardhshëm. Zuka ka "hapur kuletën" dhe, pas analizës me kryesinë dhe shtabin teknik, po përpiqet të sjellë super-transferime në klub. "Olle" raporton se klubi bard-

hekuq është në bisedime të avancuara me tre yjet e Superligës, Mentor Zhdrellën e Llapit dhe dyshen e Prishtinës, Ahmet Januzin e Armend Thaqin.



Houstoni mezi e mposhti Milwaukeeen

ORLANDO, 3 GUSHT - Janë luajtur gjashtë ndeshjet e radhës në NBA, kompeticion që po e përfundon sezonin e rregullt në "Disney World", në Orlando, me tri fusha në dispozicion. Brooklyn Nets mposhti Washington Wizardsin 118-110 falë paraqitjes së shkëlqyeshme të Caris LeVert, që e mbylli sfidën me 34 pikë, pa harruar 27 pikët e Joe Harrisit dhe 22 pikët e 15 "reboundet" e Jarrett Allen, ndërsa në radhët e Wizardsit spikatën me 30 pikë dhe 13 rikuperime Thomas Bryant dhe Troy Brown, sërish me "double double", 22 pikë e 10 "rebounde".

San Antonio Spurs triumfuan ndaj Memphis Grizzliesit me vetëm dy pikë diferencë: 108-106. Pesë basketbollistë të skuadrës nga Teksasi kishin numër dyshifror pikësh, çka tregon forcën e lojës së tyre kolektive. Spikati me 21 pikë dhe 10 rikuperime Dejounte Murray, ndërsa për Grizzlies për pak realizoi "triple double" J.



Morant (25 pikë, 9 "rebounde" dhe 9 asistime). Me gjithë përpjekjet e Damian Lillardit (30 pikë e 16 asistime) dhe Jusuf Nurkiçit (30 pikë), Portland Trail Blazersi nuk ia dolën ta shmangnin humbjen përballë Boston Celticsit, duke u dorëzuar në fund me rezultatin 124-128. Skenën e rrimbeu Jayson Tatum me 34 pikë, ndërsa Jaylen Brown shtoi edhe 30 pikë të tjera për Celticsin.

Giannis Antetokounmpo bëri të pamundurën përballë Houston Rocketsin, duke shënuar plot 36 pikë dhe dhënë 18 asistime, por Milwaukee Bucks u dorëzua vetëm në minutat e fundit me

rezultatin 120-116. Vendimtare në këtë sukses të teksanëve dyshja Westbrook - Harden, me 55 pikë në total (31 dhe 24). Fitore e dhimbshme për Orlando Magicin, që mundën Sacramento Kingsin 132-116, por humbën Jonathan Isaac, i cili këputi ligamentit anësor kryqëzues. Për të sezoni ka përfunduar. Pavarësisht prej paraqitjes fenomenale të Luka Donçicit, i cili realizoi 40 pikë dhe rikuperoi 11 topa dhe 30 pikëve të Kristaps Porzingisit, Phoenix Sunsi fitoi 117-115 ndaj Denver Guggetsit falë 30 pikëve të Devin Bookerit dhe 20 të Ricky Rubioit.

REZULTATET

Washington Wizards - Brooklyn Nets	110-118
Portland Trail Blazers - Boston Celtics	124-128
San Antonio Spurs - Memphis Grizzlies	108-106
Sacramento Kings - Orlando Magic	116-132
Milwaukee Bucks - Houston Rockets	116-120
Dallas Mavericks - Phoenix Suns	115-111

Hoeness: Ata e kanë mendjen për biznes, Bayerni special

MUNCHEN, 3 GUSHT - Bayern Munchen fitoi kampionatin, Kupën e Gjermanisë dhe tani është fokusuar në Ligën e Kampionëve. "Bavarezët" kërkojnë Tripletën, ndërsa Uli Hoeness, ish-presidenti i rekordmenëve gjermanë, ka sulmuar rivalët e Dortmundit në një prononcim për FAZ. "Nëse Dortmundi blen një lojtar të talentuar dhe ky nis e luan ndeshje pozitive, brenda disa muajsh nga vetë klubi ose nga jashtë, menjëherë nis të diskutohet shitja e tij. Dhe unë pyes veten: 'Si mundet që një lojtar ta përthithë 100% ADN-në e një klubi kur vendoset menjëherë në merkato?' Te Bayern Muncheni nuk arsyetohet në këtë mënyrë, ne nuk e kemi bërë kurrë një gjë të tillë. Nuk blejmë lojtarë për të



bërë biznes me ta. Një futbollist i yni duhet ta ketë ndjesinë që do

të luajë gjithmonë me Bayern Munchenin", ka thënë Hoeness.

SHKURT

Shabani, largimi i radhës nga Gjilani

Edhe një futbollist është larguar nga Gjilani pas përfundimit të edicionit futbollistik 2019/20. Bëhet fjalë për Kushtrim Shabanin, i cili sot ka konfirmuar ndarjen me bardhëkuqet. Shabani ka falënderuar të gjithë anëtarët e klubit dhe presidentin Florim Zuka për mbështetjen e vazhdueshme. "Nga sot më nuk do të jem pjesë e SC Gjilanit! Një sërë falënderimesh shkojnë për presidentin, drejtorët, bashkelojtarët, stafin e klubit dhe tifozerine e klubit ultas 'Skifterat' për përkrahjen. Gjithashtu SC Gjilanit i dëshiroj shumë suksese në arenën ndërkombëtare", thuhet në njoftimin Shabani. Ai realizoi gol në ndeshjen e parafundit ndaj Ballkanit, duke i bërë "Skifterat" që për disa minuta të ëndërrojnë titullin kampion.

Barça nuk do ta nënshkruajë me Neymarin

Skuadra e Barcelonës nuk do të jetë në gjendje të nënshkruajë kontratë me futbollistin Lautaro Martinez nga Interi apo me Neymar nga Paris Saint-Germain. Kështu ka bërë të ditur presidenti Josep Maria Bartomeu, i cili ka shtuar se katalunaist nuk do të jenë në gjendje të nënshkruajnë futbollistë të shtrenjtë gjatë kësaj vere, shkruan "Goal". Bartomeu e ka pranuar se kriza e shkaktuar nga përhapja e pandemisë COVID-19, e ka futur klubin në një gjendje të pasigurisë financiare.

Muller: Dua të pensionohem në Bayern

Thomas Muller ka mohuar se ka kërcënuar drejtuesit e Bayern Munchen me largim. Sulmuesi gjerman ka konfirmuar se dëshira e tij është që të pensionohet në klubin gjerman. "Kërcënimet e mia për largim? Nuk është e vërtetë se kam kërcënuar njeri. U kam thënë drejtuesve se doja të luaja më shumë dhe kaq. Bayerni për mua është gjithçka, këtu jam rritur dhe këtu dua ta mbyll karrierën", ka thënë Muller.

Conte mund të largohet nga Interi

Antonio Conte mund të largohet nga Interi. Sipas mediave italiane, raportet jo të mira të trajnerit italian me krerët e klubit kanë bërë që të diskutohet e ardhmja e tij. Conte e mbylli me Interin sezonin në pozitën e dytë me 82 pikë, por as kjo nuk ka mjaftuar për drejtuesit e Interit, të cilët do të nisin bisedimet për të prishur kontratën me marrëveshje të dyanshme. Vendi në Contes në pozitën e trajnerit tek Interi mund ta zërë Maxi Allegri. Allegri është i papunë që prej largimit nga Juventus.

Formacioni i vitit në Serie A

"Opta Data", sajt i njohur i statistikave në futboll, ka përpiluar top-formacionin e sezonit që u mbyll në Serie A. Bie në sy dominimi i Juventusit. Kështu, 4 lojtarë janë bardhezintë, kampionë të Italisë, mes të cilëve portieri Szczesny dhe Cristiano Ronaldo. Vetëm një nga Interi, në qendër të mbrojtjes. Fjala është për holandezin De Vrij. Në këtë formacion ideal të Serie A, Lazio përfaqësohet nga Acerbi në mbrojtje, Luis Alberto në mesfushë dhe "Këpuca e Artë" e Evropës, veç asaj të Italisë, Ciro Immobile, në sulm. Theo Hernandez është emri i vetëm nga Milani, ashtu sikurse Ruiz nga Napoli dhe Gomes nga Atalanta. Kjo përzgjedhje është bërë mbi bazë statistikash specifike për secilin rol nga "Opta Data", ndaj kjo 11-she ideale e Serie A për sezonin që sapo u mbyll merr vlera të plota objektiviteti. Sikurse duket në paraqitjen grafike, ky formacion është sipas modulit 4-2-3-1, me bomberin e Lazio në majë. Ronaldo dhe Dybala janë krahët e ofensivës, "made in" Juventusit. Formacioni: Szczesny, Cuadrado, De Vrij, Acerbi, Hernandez, Alberto, Ruiz, Dybala, Gomez, Ronaldo, Immobile.

REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLICA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 03.08 2020
Primjeto:

Njoftimi për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Emin Duraku"
Komuna: Lipjan
Data: 04.08.2020

Njësia Jodolica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
4-400	32859	

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/023-G/1.1	Blerje e mjeteve te teknologjisë

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Emin Duraku", Lipjan. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
 - Loptop 2 Copë
 - Projektor me perde 2 Copë
 - Maus Wireles 2 Copë
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
 - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Emin Duraku" Lipjan, më së largu deri më 12.08.2020
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues:
Hazbi Sahiti
Telefoni: 044 183-336
E-maili: hazbi.sahiti@hotmail.com

REPUBLICA E KOSOVËS
KOMUNA LIPJAN
REPUBLICA KOSOVO
OPŠTINA LIPLJAN

Pranuar më: 03.08 2020
Primjeto:

Njoftimi për shprehje të interesit
Emri i shkollës: "Emin Duraku"
Komuna: Lipjan
Data: 04.08.2020

Njësia Jedinica	Numri Broj	Shtojca Dodatak
4-400	32864	

Numri i kontratës:	Emri i kontratës:
ESIP/SDG/023-G/1.3	Vegla për Edukatën Muzikore

Qeveria e Kosovës ka marrë një kredi nga grupi i Bankës Botërore për realizimin e projektit për përmirësimin e sistemit të arsimit (ESIP), dhe ka për qëllim që një pjesë të grantit ta përdor për ta përkrahur Ministrinë e Arsimit, të Shkencës dhe të Teknologjisë dhe Shkolles SHFMU "Emin Duraku", Lipjan. Në kuadër të kësaj përkrahjeje do të realizohet prokurimi si në vijim i pajisjeve të nevojshme:

- Përshkrimi i mallrave të nevojshme:
 - Vegla per Edukatën Muzikore
- Kriteret minimale për kualifikim të kontraktuesve që mund të aplikojnë janë:
 - Përvoja e suksesshme në ekzekutimin e kontratave për ofrimin e mallrave të natyrës së ngjashme në dy vitet e fundit;
 - Regjistrimi ligjor i firmës nga autoritetet vendore.
- Kontraktuesit e interesuar që i plotësojnë kriteret minimale për kualifikim, të cekura më lartë, janë të mirëseardhur të aplikojnë me shprehjet e tyre të interesimit kundrejt specifikimit të hollësishëm teknik në adresën e SHFMU "Emin Duraku" Lipjan, më së largu deri më 12.08.2020
- Specifikimi i hollësishëm teknik së bashku me afatet dhe kushtet e tjera, ku të gjitha janë të përgatitura në kuadër të një dokumenti të quajtur Ftesë për ofertë-Mallra, do t'ia dorëzojë shkolla vetëm atyre kontraktuesve potencialë që i plotësojnë kriteret. Kompanitë luten që t'i shkruajnë detajet kontaktuese me rastin e Shprehjes së Interesit.

Detajet kontaktuese të shkollës:
Personi kontaktues:
Hazbi Sahiti
Telefoni: 044 183-336
E-maili: hazbi.sahiti@hotmail.com



Kompania Regjionale e Mbeturinave "UNITETI" Sh.A - Mitrovicë

Në bazë të Ligjit për Ndërmarrje Publike Nr. 03/L-087, i ndryshuar dhe i plotësuar me Ligjin 04/L-111 dhe në harmoni me Ligjin për Menaxhimin e Financave Publike dhe Përgjegjësitë, Nr.03/L-048, neni 14, dhe Statutit të Kompanisë, KRM "UNITETI"SHA-Mitrovicë, shpall këtë:

KONKURS

Pozita: Kryepunëtor
I përgjegjjet: Menaxherit të Njesisë
Vendi: Vushtrri

Detyrat dhe përgjegjësitë kryesore:

Të jet i aftë që me orar të plotë dhe pa kufizime të kryej detyrat sipas kontratës së punës,

- Mbikëqyrë, udhëzon dhe këshillon vozitësit dhe punëtorët e grumbullimit të caktuar në ndërrimin e tij/saj
- Monitoron implementimin e grumbullimit të mbeturinave, pastrimin e hapësirave publike gjatë ndërrimit të tij/saj konform planit ditor
- Aplikon rregullat e sigurisë, rregullat e grumbullimit, rregullat e trafikut dhe rregullat tjera për vozitësit dhe punëtorët e grumbullimit
- Plotëson raporte ditore të cilat përmbajnë informata rreth implementimit të punës, shkeljet e mundshme dhe masat e ndërmarra
- Cakton ekipet ditore të punës sipas planit operativ,
- Përgatitë planet e marshutave/turrave dhe organizon fushata të pastrimit,
- Kontrollon kuantitetin dhe kualitetin e punës,
- Mbanë ditarin e punës dhe shenon procesin ditor për mbarëvajtje dhe moskryerje të detyrave,
- Përgjegjës për udhëheqje dhe mbikëqyrje të grupeve punuese,
- Përbushë detyra tjera sipas nevojës,
- Përgjegjës për përdorim të rregullt të paisjeve dhe të mjeteve të punës,
- Përgjegjës për siguri dhe shëndet të punëtorëve gjatë punës,
- Bashkëpunon me inkasantët,
- Përgjegjës për disiplinë të punëtorëve gjatë orarit të punës, përgatitë mjete dhe paisje tjera të nevojshme për punë,
- Mbanë kontakte me klient dhe zbaton në mënyrë të shpejtë ankesat që dërgohen nga Menaxheri i Njesisë,
- Përgjigjet dhe raporton tek Menaxheri i Njesisë,
- Përbushë detyra tjera nga zona e tij e përgjegjësisë sipas kërkesave të Kryeshefit Ekzekutiv dhe Menaxherit të Njesisë.

Kushtet dhe kualifikimet e kërkuara:

- Të ketë shkollim të mesëm
- Kopja e letërnjoftimit,
- Dëshminë se nuk jeni nën hetime, jo më të vjetër se 6 muaj.

Dorëzimi i kërkesës dhe dokumentacionit përkatës bëhet tek Zyra e Arkivës. Konkursi zgjatë 15 ditë, nga dita shpalljes.

Kërkesat e dorëzuara pas afatit dhe të pakompletuara me dokumentacione përkatëse, nuk do të merren për shqyrtim nga ana e Bordit Drejtorëve. Vlerësimi formal dhe intervista do të bëhen pas përfundimit të afatit për aplikim, ndërsa NP mban të drejtën e formimit të listës së shkurtër me aplikant.

>> SHPALLJE TË VOGLA <<

► "Medical & Laboratory Services" Sh.p.k shpall të pavlefshme certifikatën e TVSH-së me numër: 330258451

► Jap banesë me qira afër 60 m2, kati III-Lagja Mati 1 Rr.Z3-Si Theodor Muzaka nr.14. në Prishtinë. Banesa posedon dhoma gjumi dhe sallon, kuzhinë, korridor banjo ballkon . Banesa është e mobiluar komplet, preferoj ta jap banesën me qira për afat të gjatë. Tel: +38344185233.

► Lëshoj banës me qira në lagjen "Dardania" në Prishtinë. Banesa ka 50 m2, me inventar të kompletuar, banesa ka kuzhinë me sallon, teras, banjo një dhomë gjumi, shpajz dhe korridor, banesa lëshohet për një qift ose për dy vajza. Tel: 044171328.

► Lëshoj shtëpinë me qira në lagjen Velania, pa pagesë sepse shtëpia ka nevojë për përkujdesje ndërsa shpenzimet mujore ti bëjë vetë banuesi si: ujë rrym bërlllok, Tel: 044-608-626.

► Lëshoj banës me qira për student apo familjar në lagjen "Mati 1" Rr. "Muharrem Feja", banesa është 70 m2 dhe i plotëson të gjitha kushtet, kati dytë ndërtim i ri tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira, banesa është ndërtim i ri dhe gjendet në lagjen "Mati 1" rruga "Muharrem Feja" Prishtinë. Tel: 044-686-900.

► Lëshoj banesë me qira në lagjen "Mati 1" përball "Super Vivës", me sipërfaqe mbi 50 m2, kati dytë me ngrohje, klimë, ashensorë etj, çmimi 200 Euro. Tel: 044-185-233.

► Lëshoj banesë me qira garsoniere në Ulpian kati i parë, posedon tre shtretër dhe e mobiluar. Preferohet për studenta ose studente, një qift apo të tjerë. Çmimi është 185 euro. Tel: 044-812-875.

► Lëshoj garsonjer me qira në lagjen Ulpiana kati i parë. Banesa është e mobiluar dhe i plotëson të gjitha kushtet për banim, preferohet për një qift apo tre studentë, mund të merret për kohë të shkurt apo të gjatë. Çmimi është 180 Euro. Tel: 044-812-875.

► Urgjentisht kërkoj një banesë me qira në Prishtinë. Banesa duhet të ketë 1 ose 2 dhoma gjumi e mobiluar ose bënë edhe e pa mobiluar. Çmimi prej: 200-250 €. Tel: 045-660-188

► Lëshoj lokalit më qira. Lokalit është i pasitur më të gjitha kushtet përcjellëse. Lokalit gjendet në lagjen e Boshnjakëve në Mitrovicë. Për informata më të hollësishme mund të na kontaktoni në këtë numër të telefonit: 049-392-275

► Lëshoj banesë me qira në Lagjen Dardania afër "Bill Clintonit", kati tretë, banesa posedon të gjitha kushtet elementare, dy dhoma, kuzhinë e veçantë me pamje nga parku me çmim sipas marrëveshjes tel: 045-891-338 ose 049-616-139

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra "Qerimi2", i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit te Furra Qerimi2, i ka dy dhoma të fjetjes, sallon me kuzhinë, shpajz dhe dy ballkone. Për info 044/332-640.

► Lëshoj banesën me qira e cila gjendet prapa AAK-së me kushte të volitshme dhe po ashtu me çmim të volitshëm. Për informata më të hollësishme na kontaktoni në numrin e tel: viber +37744162783 dhe 049/900-994.

► Lëshoj banesën me qira në lagjen Bregu i Diellit 2 te banesat e bardha, afër Shkollës Iliria banesa është dy dhomshe e mobiluar komplet, për info lajmërohuni në tel: 044/262-940 dhe 049/ 737-867.



Republika e Kosovës
Republika Kosovo/Republic of Kosovo
Kuvendi Komunal Dragash/Skupština Opštine
Dragaš/Drags Municipality
DREJTORIA KOMUNALE PËR ARSIM



Br.13/335
Dana: 30.07.2020
D r a g a s

Na osnovu Zakona o pred univerzitetskom obrazovanju u Republici Kosovo br.04 / L-032, člana 8 Zakona o radu u Republici Kosovo, br.03 / L-212, člana 5 Zakona o obrazovanju u opštinama Republike Kosovo br.03 / L-068, Administrativno uputstvo (MONT) br.10 / 2018 od 20.07.2018 o normativu o stručnom kadru opšteg obrazovanja, Administrativno uputstvo br.05 / 2015- normativ za nastavnike stručnog obrazovanja, Administrativno uputstvo Br. 2017/2017, za regulisanje postupaka za konkursa u javnom sektoru, odluka MONT-a br. 32 / 01B, odluka MONT-a br. 311 / 01B od 04. avgusta 2015. godine, zahtev MONT-a br.2-2955 od 01. jul 2016. Opštinska direkcija za obrazovanje u Dragašu objavljuje:

KONKURS- redovan

Za popunjavanje slobodnih mesta za predškolsko, niže i srednje srednjoškolsko obrazovanje opštine Dragaš za školsku 2020/2021 godinu.

OSNS "9 Maji" Rapča

1. Jedan nastavnik za muzicko vaspitanje

OSNS "Zenuni" Brod

1. Jedan nastavnik za razredun nastavu
2. Jedan nastavnik za Fiziku
3. Jedan nastavnik za Biologiju
4. Jedan nastavnik za likovno vaspitanje

OSNS "Svetlost"- Kruševo

1. Jedan nastavnik za Hemiju
2. Jedan nastavnik za razrednu nastavu Zlipotok

OSNS "Restelica"

1. Jedan nastavnik za Matematiku
2. Jedan nastavnik za Fiziku (12 časa)
3. Jedan nastavnik za hemiju (10 časa)
4. Jedan nastavnik za Historiju
5. Jedan nastavnik za Geografiju
6. Tri nastavnika za razredun nastavu

OSNS " 28 Nëntori"- Bresanë

1. Tri nastavnika za razrednu nastavu (dok se radnice ne vrata sa porodiljskog odsustva)

OSNS " Shaban Shabani " Llopushnik

1. Jedan nastavnik za razrednu nastavu u Pllavë (dok se radnice ne vrata sa porodiljskog odsustva)
2. Jedan nastavnik za razrednu nastavu Pllavë

OSNS " Fetah Sylejmani" Dragash

1. Jedan nastavnik za razrednu nastavu Shajne

SHML "Ruzhdi Berisha" Dragaš

Nastava na bosanskom jeziku

1. Jedan nastavnik za predmet albanskog jezika (dok zaposleni Selim Kryeziu ne okonča svoj politički mandat na mestu zamenika ministra ili ako imenovanje ne bude prekinuto ranije)

Nastava na bosanskom jeziku

1. Profesor stručne prakse u obrazovnom profilu Opšte sestrinstvo

I. Ovi dokumenti se trebaju priložiti uz prijavu:

- Obrazac za prijavu (dobija se u ODO gde se prijave podnose sa drugim relevantnim dokumentima.);
- Lični dokument (kopija lične karte ili pasoša);
- Diploma mora biti overena originalom, u suprotnom se ne smatra važećom (ili potvrde), uverenja umesto diplome moraju biti overena kod javnog Notera i ne starija od šest meseci;
- Kandidati koji su završili studije izvan Republike Kosovo moraju doneti nostrifikovani diplomu;
- Potvrdu da osoba nije pod istragom;
- Dokaz iskustva u obrazovnim ustanovama (ako ih ima).

Početak rada na gore pomenutim mestima neće nužno biti 01.09.2020., Već u zavisnosti od stvarnog oslobadjanja radnog mesta u IEAA (datum penzionisanja ili porodiljskog odsustva, itd.).

Konkurs ostaje otvoren 15 dana od dana objavljivanja u medijima.

Napomena: Popunjena konkursna dokumentacija se ne vraća kandidatima.

Datum: 30.07.2020
Dragas

Direktor ODO-a
MSc. Vloran Cenaj

v.v _____



REPUBLIKA E KOSOVËS
REPUBLIKA KOSOVA
REPUBLIC OF KOSOVO



KOMUNA E LIPJANIT
OPŠTINA LIPLJAN
MUNICIPALITY OF LIPJAN

DREJTORIA E ARSIMIT

Nr-4-111-33050
Datë: 03.08.2020

Në bazë të Nenit 8, paragrafi 1 dhe 2 të Ligjit të Punës Nr. 03/L-212 (Gazeta Zyrtare e Republikës së Kosovës, Nr. 90/2010), Nenit 5, pikës c. të Ligjit për Arsimin në Komunitet e Republikës së Kosovës Nr. 03/L-068, Nenit 4 dhe 5, të Udhëzimit Administrativ Nr. 07/2017, për Rregullimin e Procedurave të Konkursit në Sektorin Publik, Drejtoria Komonale e Arsimit në Lipjan shpall:

KONKURS Për plotësimin e vendeve të punës

- SHFMU "Hasan Z. Kamberi" Silovi

Një (1) Mësues/e klase (Me kohë të caktuar)

Kushtet e kërkuara:

Aplikacionit i bashkëngjiten këto dokumente:

- Aplikacioni i plotësuar (merret në komunë – Qendra për Shërbime me Qytetarë sporteli nr. 3);
- Dokumenti personal (letërnjoftim ose pasaportë);
- Diplomë (Çertifikatë) fotokopje të vërtetuar nga organi përkatës
- Certifikata që nuk jeni nën hetime.
- Dëshmi të përvojës në institucione arsimore (nëse ka).

Kriteret e kualifikimit:

Përgatitje adekuate profesionale, në bazë të normativit 10/2018 (MASHT),

Kandidatët me kualifikime jo përkatëse dhe ata të pakualifikuar sipas këtyre ligjeve dhe UA nuk do të merren në shqyrtim, përkatësisht refuzohen.

Si informata të sakta do të konsiderohen vetëm ato informata, të cilat janë të dëshmuara me dokumente (jo ato që janë vetëm të deklaruara pa dëshmi).

Personat që kanë diplomuar jashtë Kosovës duhet të kenë të nostrifikuar diplomat nga MASHT.

Për intervistë do të ftohet ata kandidat të cilët i plotësojnë kushtet sipas akteve ligjore të lartcekura.

Informimi i kandidatëve aplikues rreth mbajtjes së testit me shkrim, intervistës me gojë dhe shpallja e rezultateve do të bëhet në Web faqen e Komunës së Lipjanit <https://kk.rks-gov.net/lipjan/> dhe në tabelën e shpalljeve.

Fillimi i punës për vendet e cekura më lartë, nuk do të jetë domosdoshmërisht më datë 01.09.2020, por në varësi të lirimimit real i vendit të punës (datës së pensionimit apo pushimit të lehonisë etj.).

Konkursi mbetet i hapur 15 ditë nga dita e shpalljes së konkursit në mjetet e informimit publik, duke filluar nga data e publikimit.

Dokumentet e pranuar nuk kthehen.



Lume's Details
Estetik & Depilim

044 900 978 | 045 681 898

Sallon Depilimi Lume's Details

lumesdetails

Mbrapa Teatrit, 4 Lullat, Rr. Bajram Kelmendi



ANNOUNCING THE 2017 QUALITY & SALES AWARDS

Quality & Sales Award Recipients

[Listed in alphabetical order]

- ★ ARC Refreshments Corporation- Antipolo **Philippines**, Quality
- ★ Embotelladora Central S.A **Paraguay**, Quality
- ★ Fabrica de Bebidas Gaseosas Salvavidas S.A. **Guatemala**, Quality
- ★ Fluidi Sh.p.k. **Kosovo**, Quality
- ★ Indústria e Comércio de Bebidas Funada Ltda **Brazil**, Quality
- ★ Interbrand S.A.L. **Lebanon**, Sales
- ★ Kofola ČeskoSlovensko a.s. **Czech Republic**, Quality
- ★ Obi Zulol CJSC **Tajikistan**, Quality
- ★ Partex Sales sales Beverages Ltd. **Bangladesh**, Quality
- ★ Soft Drinks Georgia **Georgia**, Sales

